ta s-mi făntescu cu buneții'i ali viață, adărat cu tiñia.

83. Duke qëndruar i paepur në këto vise shkëmbenjësh

1.
Përmbi ballin tim të stër- rrahur erërash të forta ashpërsisht,
që mes për mes tij më depërtojnë thellë në shpirt si shigjetë,
duke më hapur në mendime të pashkelurat shtigje të jetës,
për të arritur ku ëndërrova banimin tok me vëllezër qetësisht.
2.
Sapo arrij pranë të bukurve pyje, përkundur nga era lehtësisht,
më duket sikur tundem në djepin prindëror si dikur dashurisht,
duke rënë në gjumë të ëmbël, mbushur plot me ëndrra fëminore,
gjer të zgjohem nën lodrime pishnajash e ahishte madhështore.
3.
Kështu më përplaset shpirti im i ngratë, tek gdhij çdo natë,
herë rrëzuar përdhe, si dru i thatë, herë shtrirë gjerë e gjatë,
dhe përnjëherë kapërcej përmbi ta, duke qeshur si i dehur,
e si ndonjë kalimtar nëpër rrugët e ashpra duke u shkelur.
4.
Kushedi sa herë jam përplasur me këto erëra shumtë të ashpra,
me shkreptima rrufesh çajnë mugëtirën si zjarre gjarpërinjsh,
me gjëmimet e shpeshta, që të kallnin drithërima të llahtarisura,
duke qëndruar i paepur më këmbë në këto vise shkëmbinjsh.

83. Chiundrindalui ca gioni tu aisti locuri di chetriț

1.
Pisti frămtulu a ñeu aspărosu, străbătut dit vinț,
ca șigheti pit elu, acesti s-ñi dispărtedz la săndz,
anda s-ñi disfacă a ñia căl'uri îndreapti tru minț,
s-agiung iu voi s-bănedz stog cu fraț fără plăndz.
2.
Cât agiung la mușatli păduri, ți s-leagnă dit vinț,
ñi aspari canda escu tu vără ghigandă sărmăniț,
iu cadu tu somn dulți, umplut cu yisi ca tru ñicuriț,
până mi dăștept sum giucărili di chiñ ș-fadz nicăpăsiț.
3.
Și s-păscănești aistu măratulu suflitu a ñeu,
cât vărnoară surpeat și tes împadi ca lemñ uscaț,
diunăoară ansară pisti el', anda arrădu ca îmbitaț,
ca văr om calatorit pi calea asproasă îngărcat greu.
4.
Caiști cât ori escu străbătut cu aisti vinț aspăroș,
cu ascăpraț'i di a fulgeriei, ți tal'i țeru negurosu ca nipărsiț,
di pi țeru bumbuledzili didea treamnari mări di fricoș,
chiundrindalui împrostu ca gioni tu aisti locuri di chetriț

84. Portreti im i përzier

1.
Përsëri erdha së largu me mall në bukurin fshatin tonë,
dhe i heshtur kam qëndruar para urës së Gurës si dikur,
duke vështruar i menduar shkëmbinjtë e bardhë borë,
që ndriçojnë si smeralde nën rezet e dielli të përflakur.
2.
Dhe që prej përfund të thellësisë fantazia ime e pashoqe,
sjell ndërmend se ç'duar i lidhën ata gurë aq mjeshtërisht,
këto shenja të stërlashta të së shkuarës së saj madhështore,
përmbi ujërat Valea Mares tonë, që shushurijnë përjetësisht.
3.
Që prej harqesh të gurtë e të bardhë, latuar bukur me dorë,
vështroj majëmalet e larta e të rënda dhe pyjet pambarim,
ndërsa së bashku me pamjen më përkunden lehtë kokëposhtë,
sikur të shtynin njëra pas tjetrës ëndrrat e mija pa pushim.
4.
Duke ma përplasur nëpër pellgjet e kthjellët imazhin nën të,
ku vështroj përzierjen e maleve, qiellit dhe portretit tim,
sikur përthyhen nën stërrahjet erërave të ngarkuara rëndë,
sikur rëndesa i mbart mbi sup tok këto bukuri pa pushim.
5.
I zhytur i tëri nën të, vështroj i habitur dhe krejt në heshtje,
portretin tim, që po më përkundet si në djep lehtë-lehtë,
dhe ashtu siç jam, ai deformohet nëpër ujërat në llokoçitje,
tok me tërbimin e lumit, rrahin gurët e bardhë pa përtesë.
6.
Me portretin tim bisedoj heshtazi, me mall si në përrallë,
por prej tij, që përkundet erës së lehtë s'del asnjë fjalë,
si i budallallepsur unë zë e flas dhe përgjigjem po vetë,
ndërsa i heshtur si memec nën ujë dhe pa gjak mbetet pas.
7.
Ndërsa erdhi çasti i ndarjes, në dëshpërim dua të të them:
"E ngrata urë, që shpëlahesh natë e ditë, në ujëra të kthjelltë,
e madhërisht qëndron kokë-lart e bisedën me ne ngërthen,
duke na rrëfyer ç'duar grabovarësh të ngritën si gjerdanë.

84. Portretu a ñeu misticat

1.
Am vinit nicaună oară la mușatea hora a noastă,
și tățit am chiundrit ninti a Puntil'ei ali Gură,
munduit cu mutrita cât la chetrili alghi a l'ei,
ți dit luñina a soarului luñinescă ca scântei.
2.
Și dit multu ahăndosea fantasia a mea fără soață,
aduc întru minti ți măñi li au ligaț chetrili ca mărdzei,
aișț semñ vecl'i a trăcutăl'ei multu maroasă a l'ei,
pisti apili a Valeamaril'ei, ți nu căpăsească vroară boță.
3.
Di pi la hărțl'i a l'ei, adrat cu chetri albi di dăltili a lor,
mutrescu pădurili și chipturi dit munțl' analț ș-grei,
încăt viderili și capturi anaptoasi ñi s-leagnă stog,
canda ñi s-leagnu un dipi alantu nidănăsati yisil'i a ñei.
4.
Mutrita ñi s-pălcănești sum ea tu peldzil'ă curaț,
iu veadu măsticat munțil'i, țeru ș-portretu a ñeu,
canda s-frăngu dit vințl'i, ți li străbati ș-li încarc greu,
canda dit îngărcari, s-țănu stog împrosț aisti mușteț.
5.
Hiptu întregu sum ea, ma mutrescu chiudusit fără boață,
portretu a ñeu, ți ma s-leagnă moali, ca tru sărămăniță,
și di cum ma chiundrescu, el s-deformedză pit apili,
ți stog cu vălăli orbi, s-agudești după alboasea di chetri.
6.
Cu portretu a ñeu acaț s-zburesc, cu boța apusă, cu dor.
ma dit năsu, ți s-leagnă dit vintu moali, nu easi zbor,
ca glaru mini greascu și mini mi răspundu năpoi,
elu tățiosu ca mutu sum apă, fără săndzi, arămăni dinăpoi.
7.
Încăt vini chirou ali dispărțiri, cu dispărari s-ță dzăc voi:
"Mărata di punti noapti-dzuă ți ti speli tu aisti apili a l'ei,
Chiundrești maroasă împroastă, ș-ni zburești noi ,
ta s-spuñ ți măñ gărvăñoti ti au adrată ca mărdzei!"

85. Bijtë e mi

1.
Papritmas e ndjej se pleqëria po më afrohet me të rëndë,
andaj po i peshoj punërat e bëra prej meje mire e mbarë
dhe duke zgjidhur me vete se çfarë do të mbetet pa bërë,
zemra më gëzohet, o bijtë mi, se do të jini ju trashëgimtarë
2.
I bindur se për atin tuaj do t'u marrë malli ndonjëherë patjetër,
kërkoëni se në vargjet e mija do gjeni këshilla të të vërtetës,
që gjithnjë të ecni veç përpara me të zjarrtit shpirtrat tuaj rinor,
gjersa të përmbushni synimet tuaja të mbara vëllazërisht tok.
3.
Prej nga të merrni aromën e poezisë së shpirtit të përflakur,
thurur mes shushurimave dehëse ndanë burimesh ujëkulluar,
që nën gëmushat e ahishteve rrjedhin ëmbëlsisht pa pushuar,
tek ato të vini ndonjëherë me mall, po ashtu si ati juaj dikur.
4.
Atëherë kur unë të jem botën tjetër nën dhe i heshtur përjetsisht,
do të prehem i bindur se të shtrenjtit e mi ecin udhëmbarësisht,
se jeni lindur e rritur nga prindër të ndershëm arumunë me dashuri,
që rraca arumune të mos humbasë në sterat e kohërave përgjithnji.
5.
Prandaj ju kërkoj fal'en tuaj se s'munda t'ju lë shumë pasuri,
por të dini së thelli shpirtit tim ishte e mbartëte mjaft dashuri,
u lashë në shqip e arumanisht vargje aromëdehëse aq të bukur,
skëterrat e jetës t'jua përndrisë nëse në nevojë i thërrisni si dikur.

85. Ficiorl'i a mei

1.
Di niaştiptatea achixeascu că auşaticu ñ-yini cu greu,
ti aţea l'-fac ghixiri a lucriloru fapti ghini şi ambari di eu,
şi dizleagăndalui pi a mea că ţi vă s-alas nifapti dinăpoi,
inimea ñă s-hărseaşti, alăi hil'i a mei, că vă s-hiţ voi.
2.
Escu convintu că poati ti ta-tu voi vă s-vi l'ea vroară dor,
cu troară căftaţmi, că la meali stihuri vă s-loţ dimindău,
ta s-imnaţ singur nănti cu sufliţl'i tinăreţoşţ di nău,
păn s-agiungieţ s-li umpleţ a văoastri obiectivi ambări stog.
3.
Dit eli vă s-loaţ ñiurizma a poezil'ei a suflitlui pirăfocoasă,
împăltit tru a şuşuriloru îmbitatoşi ningă alu curaţl'i şopori,
ţi cură fără dănăseari sum a gămuşil'ei di fadzi verdzoasă,
aşiţ ca tatu a voastru vi îngănu s-nidzeţ vărnă oară la eli.
4.
Atumţea când eu s-hiu aco la tăţita duñeaua alant sum loc,
convintu vă s-căpseascu că scunchil'i a mei imnu ambara cali,
că hiţ aminteaţ şi cărscuţ di părinţ tăñisiţ arămăñ cu dor,
ţi soia armănească s-nu cheară putei hiptă întru chiroil'i lai.
5.
Ti aţea vi caftu s-mi hărăsiţ că nu putui s-vi alasu multu aveari,
ma s-ştieaţ că întru suflitu a ñeu fu umplut împlinu cu maru dor,
pri arbiniseaşti şi armăneahti vi alăsai singur stihuri muşeati,
chisita ali bani s-l'i u luñinşteaşti când s-vreaţ s-l'i strigaţ voi.

86. O trim
(sipas motivesh popullore arumune)

O trim, që po këndon mbi pemë, me zë të bukur,
të më sjellësh nga larg mua gëzimin e humbur,
se me mall po të pres e shkreta dhe loti m'u sos,
hajde shpejt mos u vono, sepse me ty do vë kurorë.

Pritmë moj e dashur, se më treti malli i dashurisë,
edhe vdekja s'më kthen takimin me vajzën e rinisë,
i ndezur si prush, tek ty do të vij menjëherë patjetër
edhe nëse do më duhet të rrugëtoj edhe jetën tjetër.

O trim i dashur, që pi ujë të ftohtë tek burimi gjithnjë,
gjumi m'u vodh që kur më rrëmbeu e shkreta dashuri
ndaj nëpër ditën dhe natën e gjatë, mos pusho së ecuri,
le ta dinë të tërë se lumturinë tonë s'e ndan dot asgjë.

Pa pushim, mal më mal i ngrati unë fluturova si zog,
bukuroshen e dashur e kërkova anembanë e ngado,
nga dashuria sa s'plasa, kur e takova befas në vathë
pa marrë asnjë sy gjumë rrinim zgjuar natë për natë.

86. A lăi gioni
(după motivi populari arămăni)

A lăi gioni, ți cănț cu ahăt mușat pisti cor,
s-ñi aduț a ñia di diparti hăriosea chirut,
că mini mărata t-aștept cu maru dor,
aidi cu troară aua, că cu tini voi s-bag curuñ.

Așteaptăm vrută, că ma mi tuchescu di dor,
nu mi șuț țiva anapta ș-canda s-mor,
apresu jar ca foc, la tini voi s-yinu fără di altă,
ș-canda s-vrea s-imnu până tu bana alantă.

A lăi gioni, ți beiă apă arați, dzuă di dzuă la șopor,
somnulu ñi s-fură di când mi arăchi laiilu dor.
ti ațea imnă tută dzua și la lunguosili nopți,
la s-ști tuț că vrerea a noastă țiva dot nu îl'i u împarți.

Mini măratlu ca pul'iu munț di munț azburai,
parti di parti și pi iuțido mușata vrută ñ-o căftai,
când niaștiptat ea u-adunai cât nu cărrpai di dor,
seară di seară șidem diștiptaț, fără nihiam di somn.

87. Ëndërrime

1.
Edhe pse vitet po më ikin e po më bëjnë më të rëndë,
ende nuk po mplaket ky shpirti im i ndezur si prush,
dhe ende derdh vargje me përkëdhel'e ëndrrash si pendë,
për të ardhmen e bukur, që vjen pa ndalur nga kurrkush.
2.
Këtë e kam ëndërruar qysh herët, në moshën e bukur të rinisë,
duke u kamur me punë të rrojmë nën përkundjen e mbarësisë,
por siç duket tani për tani e paarritshme është ajo ende për ne
se do na duhet të derdhim pambarim djersën edhe nëpër re.
3.
Por asnjëherë s'pushon e s'hesht ky i shkreti shpirti im,
ai veç se ëndërron, ëndërron dhe beson gjithnjë me gëzim,
sepse po afrohet dita e ngarkuar me bukuritë e mirësisë,
sepse po vini tek ne duke na e sjellë këtë lajmë të lirisë.
4.
Po ç'dreq qenkërka ky i shkreti shpirti im i ndezur flakë,
që di vetëm të përkundet ndër ëndrra të bukura ndajnatë,
dhe të fshihet shpejt nga trembja e pamjeve të mallkuara,
në vend që t'i godasë me vargje të shpëtojë nga ky merak.

87. Yisuri

1.
Și cățe añl'i ma ñă treac ș-mi fac ma greu,
nica nu s-aușești aistu apresulu suflitulu a ñeu,
nica ñi vearsă stihuri adărat cu mușațl'i yisoñ,
ti yinitorlu, ți ma ñi yini ca mușatușă di loc.
2.
Aistă u am yisat dit chiroulu tu tinirața a mea,
ta s-agiungem s-bănăm cu multu aveari și buneț,
ma cum s-veadi ti noi mărațl'ă multu dăparti ieasti ea,
cățea s-vrea s-vărsăm sudoari tu lucrări și pit negreț.
3.
Ma putei nu căpășești aistu măratulu di suflitu a ñeu,
el singur yiseadz, yiseadzi și pistipești tu pisti,
că ma s-apruchi dzuua îngărcat cu mușteț di ambari,
că ma viniț la noi, aduțendalui libertata ca mijdeau.
4.
Ma ți dreac fuscărca aistu apresulu suflitu a ñeu,
ți singur ști s-leagnă tu yisil'i ambari ș-mușaț,
și s-ascundi troară dit aspărara di viderili bălstămaț,
tu loc ți s-li agudescă cu stihuri ta s-scap dit aistă arau.

88. E ardhmja

1.
Vërtetë na ka ndodhur të dehemi ndonjëherë secilit prej nesh,
dhe shpirtrat tanë të mjerë na përflakën si zjarr prej mendimesh,
si hekurat që kaliten e kthehen në çeliqe në kudhrat e farkave,
ndërsa e ardhmja më përkund lehtazi si era e lehtë sokakëve.
2.
Edhe pse pleqëria po ma rrëmben burrërinë time të shkurtër,
që dua të përkundem edhe njëherë si fëmijë i vogël në djep,
se jam i panginjur me mirësitë, që vijnë e ikin si era në degë,
gjersa të rroj e ardhmja fshehur brenda meje do jesë patjetër!
3.
Ma ndjen kjo zemra ime, që më rreh fortë në gjoks si çekiç,
sepse ne arumunët, banorë të shtrenjtës sonë nënë Shqipëri,
me vëllezërit trima shqiptarë, prej armiqsh e çliruam tok,
gjithnjë e më shumë do ta zbukurojmë si nuse të re këtë tok'.
4.
Pastaj edhe të shkretët, të ikurit tanë aq shumë të dëshpëruar,
do të vij dita që do të kthehen këtu në Atdhenë e tyre përsëri,
dhe brezave të rinj do t'u lëmë pas gëzimin e amshuar,
që do ta zbukurojmë Shqipërinë si vendet e tjera me bukuri…

88. Ynitorlu

1.
Cafișunu di noi cu de alihea s-îmbiteași căt vărnă oară,
di munduerili, măraţl'i di sufliţl'i, ni s-aprindi ca foc,
ca hieru arușat, ți s-adară pit fărți{14} cu agudiri multă mări,
încăt ynitorlu leagnă pi anarga, ca vintu chipturili di poñ.
2.
Ș-căţea auşatculu ma ñă aricheşti bărbăteţea şcurtă,
nica unoară multu voi s-mi legnu ca cilman tu sărămăniţ,
că escu nifăntită cu buneţăli ți ñă yină și fug ca vinţ,
până s-eascu yii yinitoru s-hibă nuntru la mini ascumtă.
3.
Ñi-acăchiseşti inima ți ñă bati ca cioc di sum siñ,
că noi armâñl'i bănători dit la scumpea patria Arbinișii,
cu a noşţ buñă fraţ arbineș u liberăm di duşmañ stog,
ma multu vă s-îl'i u muşutăm ca înveastă nau aistu loc.
4.
Dapoia și aţel' măraţl'i fudziţ a noşţ tru xenii dispireaţ,
vă s-yină dzua ți aua vă si s-şuţ la Patri a lor năpoi,
și haraua mari, fără sinori, vă s-alasă tri bărrl'i năi dinăpoi,
vă s-u umplu Arbinișia, ca locurli xeañ, împlină cu muşuteaţ.

89. E shkuara

1.
Do të na duhet ta kthejmë kokën mbrapsht ndonjëherë përsëri,
ashtu si të palodhurit udhëtar e matin rrugëtimin e lënë pas,
si kemi qenë dhe si kemi rrojtur ne arumunët në vështirësi,
duke mbartur shpirtin e stërgjyshërve tanë, rritur nëpër mal.
2.
Ndërsa qiellin e sterrosur mjegullash ta përflakim rishmëzi,
dhe nëpërmes tij të çajmë përpara me guxim ne rrugën e re,
pa frikë, pa dëshpërim dhe pa vuajtje, siç e ëndërruam gjithnji,
për ta zbukuruar tërë vendin me mendjen e duart tona punëtore.
3.
Nga njerëzit e kësaj bote dihet, se po s'pate një të kaluar,
s'mund të kemi as të sotme, por as të ardhme të ëndërruar,
ndaj t'i bluajmë mirë mendimet me mendje si në mulli,
dhe ato që i kemi bërë shtrembër duhet t'i bëjmë së mbari.
4.
Sot le ta shkundim prej jetës tonë të shkuarën plot me ligësi,
me uri, varfëri, frikë dhe krejt të zhveshur nën qiellin e kaltër,
së bashku zënë dorë pas dore arumunë e shqiptarë si vëllezër,
ta veshim të shtrenjtën Shqipëri me dashuri vetëm me mbarësi.

89. Tricutlu

1.
Va s-ni lipseşti ți capu cătvăroară s-îl'i u şuțăm dinipoi,
ca cum niacurmațl'i imnitori măsură cala armasâ nâpoi,
că cum aveam fut şi cum aveam bănat noi armâñ,
anda ținem suflitu apres, dit la a noşț păpăñ ş-străpăpăñ.
2.
Ta s-îl'i u aprideam ca jar țerulu lăit dit negurl'u a chiroulu,
şi pit namsa di el s-disfățem noi vruta, îndreapta cala nau,
fără aspărari, fără dispirări ş-fără suferință cum îl'i u sperau,
cu minta şi măñl'i a noasti s-îl'i u muşutăm întreg loculu.
3.
Să şti di tuț oamñi a lumiľei, că ma nu avuşună tricută,
nu puteam că s-aveam niți azea, niți yinitorlu a noastă,
ti ațea s-li măținăm ghini minduirli tu minti, ca tru moară,
şi ațeali ți li avem feapti străbmti s-l'i îndirdzem ambăr.
4.
Astădz s-li scutrăm dit viața a noastă tricuta cu răilii,
cu foami, oarfăñami, aspărari şi sum ție dispul'ați,
diadun, acțaț măñ di măñ armâñ şă arbăneş ca fraț'
s-u învăştem scumpea Arbinişi singur cu vreari ambării!...

90. Këlyshët e Mumës[1)]

1.
Edhe pse që atëherë janë rrokullisur mjaft kohëra me furtunë,
por bushtrën plakë, i menduar, e sjell ndërmend kushedi sa herë,
as sot e kësaj dite s'di ta shpjegoj kush dhe pse quajti "Mumë",
por veç së bashku me të vrapoja ngado pa frikë dhe nëpër erë.
2.
Por një ditë, nga xhelozia, s'u përmbajta dhe Atës ju luta ngultazi:
"Atë e dashur, pse përkujdesesh shumë për mumën e shkretë!?"
Ajo pa u menduar dhe me zë të ëmbël m'u përgjigj menjëherë:
"Është mbarsë, e shkreta ajo, ka uri e do të pjellë këlysh rishtazi."
3.
Pastaj edhe unë vetëm, ose bashkë me të shtrenjtën Atën time,
e ushqeja të shkretë atë me copëra të shumta të mbetura nga ne,
gjer të ngopej e shkreta mumë, hante pa pushim shumë e uritur,
si ta dinte se këlyshët do t'i sillte në jetë trima e të pamposhtur.
4.
Ndërsa një ditë, e shtrenjta Atë, ngadalë më thirri herët mëngjes,
"Shpejt, vrapo, të shohësh bijtë e mumës, që janë aq të bukur!"
një ditë i pashë në kosheren me sytë e mi kureshtar i çuditur,
dy këlyshët të uritur e të majmë si shakuj të bardhë përmbi thes.
5.
Më pas, si shkuan dy-tre vjet, bushtra plakë u sëmur rëndë,
dhe e mplakur ngordhi në kosheren pranë kasolles nën lëmë,
duke vështruar këlyshët e shtrenjtë, Muron e Balon me dashuri,
e bindur se janë aq të fortë, sa s'ka ujk t'i mposhtë këta bij të ri.

1) Mumë quhej buçja

90. Cățăl'i a Mumil'ei[1)]

1.
Șă cățe di atumțea sunt arucutiț furtunoasi mulț chiroi,
ma bătrăna cățauă, munduit, îl'i u aduc tu minti năpoi,
și până astădz nu îl'i u știu cai și cățe pri ea „Mumă" u-încl'imă,
ma diadun cu ea, am avrapit iuțido și pit vinț, fără frixă.
2.
Maună dzuă, di gielozi, nu mi țănui și a Atil'ei l'-căftai:
"Ată giane, spuñimi, cățe îl'i u mutrești ahăt lăita Mumă!?"
Ea nu s-mundui ma cu boața a l'ei dulți, apandasi ñi dedi:
"Easti greu, mărata di ea, ari foamă că vă s-feată cățăl'ă."
3.
Dapoia ș-mini singur, incă diadun cu scupea Ată a mea,
îl'i u hărneam șcreta di Muma, cu mușcături ți ñă arămănea,
măratea di Mumă mănca fomoasă, nidăseari păn si s-făntea,
canda îl'i u știea că cățăl'i a l'ei săntoș tu bană vă s-îl'i scutea.
4.
Maună dzuuă, scumpea Ată, pi anarga mi strigă tahinea:
"Cu troară, avrap, ta s-vedz a mumiei hil'i multu mușaț!"
La cohiu a l'ei curioz și chiudusit, vădzui cu ocl'i a ñei,
doi cățăl'i săntoș, groș ca foali, cu peril'i albi ca a neul'ei...
5.
După ți tricură doi-trei añ, bătrăna cățau să lăndădză greu,
și măratea supsi tu cohiu, ningă a clivil'ei dit aușatcu,
mutrindalui cățăl'i a l'ei scunchi, Murulu și Balulu, cu dor,
convins că sănt ahăt săntoș, căt nu s-alfă lup s-l'i sărup pri loc.

1) Mumă s-încl'ima cățaua

91. Përrallat e Gjyshes (Atës)

1.
S'më harrohen përrallat e bukura të gjyshes time asnjëherë,
që me ëmbëlsi për çdo natë pa fjetur m'i tregonte me dashuri,
s'pushonte së rrëfyeri gjersa të rrëmbente gjumi si gjithnji,
ndërsa unë, tërë kënaqësi, i mbyll'a sytë si ndonjë zotni i vërtetë.
2.
Kur në të bukurëzën arumanisht m'i rrëfente me aq bukuri ato,
ndërsa më shkonin të gjitha përmes koshiencës time si karvan,
duke luftuar burrërisht me kuçedrat tri kokëshe trimat me nam,
bukuroshëzen e dheut prej të vjellash përvëluse e shpëtonin tok.
3.
Pastaj daroviteshin me ditë të mbara, të gëzuara si në përralla,
me prindërit, sojin, miqësinë dhe shokët e tyre gëzoheshin tok,
nga shtëpitë gazi i lindjes së nipave e mbesave kurrë s'u sos,
duke pritur ta mbyllin jetën tyre shëndetplotë e pa andralla.

92. Shqipëria, atdheu im

1.
Që sapo zgjohem herët në mëngjes nga gjumi im i rëndë,
para sysh më shpaloset pambarim pamja madhështore,
me male të lartë, fusha të gjëra, lumenj e pyje hijerëndë,
Shqipëria që veç zbukurohet me dashuri duarsh punëtore.
2.
Vallë mund të ketë tjetër të gëzuar si unë sot përmbi tokë,
me gëzimet dhe dashuritë e mija në shpirt të dehet prej jush,
moj e shtrenjta Shqipëri, nuse të reja e dhëndurë zemër prush,
për ty e kanë dhënë dhe do ta japin gjakun arumunët me okë.
3.
S'mund të gjenden popuj të tjerë në gadishullin Ballkan,
duke punuar e mbrojtur atdheun tok si vëllezër trima e azgan,
një jetë të tërë gjithnjë arumunë e shqiptarë me dashuri,
duke e çuar emrin e Shqipërisë drejt rrugëve me mbarësi.

91. Părmithl'i a Atil'ei

1.
Nu li agrişescu părmithl'i a scumpil'ei Ată a mea putei,
ți ñi l'i-spunea cu dor seară di seară, ninti a durñiril'ei,
ea nu s-dănăsea s-spuneri păn s-mi arichea dulțu somn,
încăt eu încl'ideam ocl'i a ñei ca vărnă di-averu domn.
2.
Când ñi îl'i spunea cu ahănt dor, pi muşatea armâneşti,
încăt a ñia ñă triția pit mintea a mea ca cărvañ împroasti,
gioñă cu anami, ți alumta cu cuciedri lăhtăroasi cu trei capti,
dit vumărăli a lor cu pirăfocăoasi Muşatea a Locului s-scăpa.
3.
Dapoia dzăli ambărişi închirdăsiti fără pidimo vinea ti năş,
cu părințl'i, soia, oaspățl'ia ş-soțl'i a lor s-hărise stog,
din casăli s-amintară mulț nipoțş i nipoati ahănt muşăț,
aştaptăndalui s-îl'i u încl'idea bana fără suferințăşi săntoş .

92. Arbinişia, patria a mea

1.
Di tahina, când mi diştept dit somnulu greu,
dininti ñi s-disfați videra maroasă fără sinori,
di munță analț, pădz lardz, păduri, văliş i trăpuri,
Arbinişia, ți s-adară cu muşuteț ş-cu doru a ñeu.
2.
Vahia cai easti hărisit ma multu di mini astădz pisti loc,
cu harauăş -vrearili a meali tu suflit s-mi îmbet di voi,
scumpa Arbinişi, nauli înveastiş i năil'i haramboi,
ti tini au datăş i vă s-l'i u da armăñl'i săndzu a lor.
3.
Nu s-află alț popuri ma buñ tu pensula di Balcan,
ți ar tricut ca frat buñ şi lucurtori măr,
ună eta întreagă, totna armâñ şi arbineş gioñ,
şi numa aArbinişil'ei îl'i u scoasăm tu căl'uri ambăr...

93. *Vrapoj shesh më shesh*
(sipas motivesh popullore arumune)

Që kur kam ardhur të banoj tek ky qytet të bukur midis urash,
shesh më shesh endem, duke vrapuar pa u ndalur si çmendur,
duke kërkuar të dashurën time sa andej-këtej përmes ëndrrash,
me dëshirën ta përqafoj, qoftë edhe vetëm njëherë ashtu si dikur.

Tek po dil'e nga shkolla jote, me çantën ngjeshur fletoresh,
me vështrimin ndaj njëri-tjetrit përballë teje mbeta i çuditur,
dhe përskuqja t'u derdh nëpër faqe, duke qëndruar të heshtur,
duke mos mundur të pështpëriste dot fjalë asnjëri prej nesh.

Ngadalë ju afrova asaj dhe i thashë me zë të ulët butësisht:
"Moj e dashura ime e shtrenjtë, si më ke qenë me shëndet!?"
"Bosh. Si ndonjë kërcu i thatë, larg të dashurit tim, medet!" -
dhe përnjëherë u përqafuam njëri-tjetrin me shumë dashuri.

Asnjë nga ata banorë të mirë s'dinte se ç'nalidhte ne të dy,
vetëm zemra e saj e vuajtur dhe vajtimi për fatin tonë të zi,
ndarja gjithë jetën s'rreshti së derdhuri mbi ne veç vështirësi,
duke rrojtur të ndarë, gjersa përgjithnjë të mbyllnim këta sy.

93. *Avrapsescu padi di padi*
(după motivi populari arămăni)

Di când am vănit s-bănedz la aistu căsăbă namsa di punţ,
şă ca vărnă om orboasu, avrapsedz pit elu pad di padi încot,
căftăndalui vruta a mea, ți mi ari arichit tutli dulţl'i yisoñ,
ningaună oară voi s-mi adun ca atumţea ți him cănăscuţ.

Când inişiş dit sculia a ta, cu cianta umplut cu cărţ
chiudusiţ armasăm n-frămti, cu mătrita dicăt unu-alantu,
încăt chiundreai tăţită împrostă, aruşătcu dulți s-ţă vărsă pi făţ,
s-scoată maşi goală vărnă zbor di noi, nu pătu niți unu.

Mi apruchai pri anarga la năs ş-pri apus îl'i dzăşu:
" A lea scumpă pisti scumpi, cum ñă eaşţ cu săntati!?"
" Cum s-hiu, goală ca lemnu uscat, fără di geanlu a ñeu?!"
şi diună oară,ună alantu ni acăţăm mbraţ cu dor mari.

Niți unu dit aţel' bănător nu ştiea ți noi doil'ă ni lăga,
singur inimea a l'ei ş-mini măratulu cu mari yisoñ,
tru întreagă bana urrutoasă noi ni agudi tiha cu dizlaga{15},
împărţăţ dol'i s-bănăm păn s-nă yini niturnatlu somn.

94. Gjëkund s'takova si ty moj bukuri e rrallë

1.
Fqinja ime e bukur, që as emrin tënd të rrallë s'e kujtoj dot sot,
por që atëherë, prej meje s'ishe veç katër-pesë vjeç më vogël,
në fushëzën e futbollit pranë shtëpisë sime atje përmbi sop,
ku për ditë loznin lloj-lloj lojërash moj vashëzë gërshetgogël.
2.
Por, kur pas dy-tri vjetësh, u largova prej atij qyteti të vogël,
të ndërtuar aq bukur, midis urash të reja për makina e këmbësorë,
më ndiqte përkundja si në djep shushurima e lumit Devoll,
dhe në të lashtin qytet të Elbasanit vajta me famil'en time tok.
3.
Që atëherë si pa kuptuar ka rrjedhur e rrokullisur mjaft kohë,
por nëse do të më dalësh papritmas përballë përmbi urat sot,
moj fqinjë ime e bukur gërshetë artë, s'besoj se do të njihja dot,
që kushedi sa e sa herë si nusja me dhëndrin loznim ne me to.
4.
Edhe pse jam shumë i vjetër, përmbi gjashtëdhjetë vjeç sot,
nëse do to takoj fqinjëzën gërshetë vockël ballë për ballë,
turpin e pleqërisë do ta flak nga ura poshtë, në përrua të sos,
do ta përqafoj, se gjëkundi s'të takova si ty moj bukuri e rrallë.

94. Muşata ca năs vroară n-am ciucutit

1.
Viția a mea muşat, ți nu ňă țăn minti cum ti ancl'eam,
ma atumțea erai patru-ținți añ di mini ma ňic,
la padea di sport ti giucari fotbal, ningă casa a mea,
iu giucam soi di soi di gioț, ale featic cu cusiț.
2.
Ma, când fudzi dit ațeu căsăbă ňic, după doi-trei añ,
construit ahăt muşat, namsa di doi punț năli ti călărañ,
năpoi mi îngănea ca în sărmăniț şuşulia a arăului Devoll
și la vecl'ia Ňocas mi duş cu fumel'a a mea stog.
3.
Di atumțea, fără aduchiri, easti arucutit multu chirou,
ma că aztădz niaştiptat vă s-ňă eşăț dininti pisti punț,
nu pistipsescu s-ti cunoscu dot viția cu cusiț ca fuňț,
ți caişti căt ori cu eli giucam ca înveasta și harambou.
4.
Ma aza eu, ş-cățea escu tricut di ilichiă, pisti şasidzăț di añ
nacă va s-mi adunu cu viția a mea, cu cusiț ňiț,
vă s-u aruc aruşina di auşatcu sum punti hima în trap,
vă s-îl'i u l'eau di guşă muşata, ca năs vroară n-am ciucutit.

95. E dashur, më je siç të kam ëndërruar

1.
Që kur mua të varfrin më ka dehur kjo dashuria jote,
vetja më duket pa mend fare, si i kredhur në budallallëqe,
sikur po fluturoj si zogjtë pa pushim maleve të larta përmbi re,
e dashur të kam ruajtur në gji, se më e shtrenjta më je!...
2.
Të kam mbajtur dhe do të mbaj me mall të zjarrtë përsëri,
gjersa zemra ime si zjarr të më rrah brenda në gjirin tim,
mbasandaj kjo jeta jonë, sido që të rrjedhë në çdo drejtim,
s'na ndan dot, moj grabovare, e bukur si gjeraqinë!...
3.
Por edhe pse me ty s'u takova ndonjëherë në vegjëli,
në imagjinatë se ç'më mbete, si dikur duke vallëzuar,
me vështrimin tënd, të mbushur plot me bukuri e mirësi,
e dashur tek unë ke mbetur, ashtu siç të kam ëndërruar!...

95. Vrută, ñ-eștă cum t-am înyisat

1.
Di când escu îmbitat tu vreari di tini, măratu di mini,
ñ-aspari vetea a mea ca glaru, dip fără minti,
canda azbor tu în ţer, ca pul'i pisti analță munț,
a lea vrută întru sinu ti am ţănut, că ñi eștă scump!...
2.
Ti am ţănut și vă s-ti ţănu cu doru apreas năpoi,
până s-ñi bati inima a mea nuntru tu siñ,
dapoia, cumțido si s-arucutescă bana pi noi ,
nu mi dispărț dot, a lea grevenască ca ghirachiñ!..
3.
Și căţe la ñicurami vărnoară cu tini nu mi adunai,
tu fănărusira a mea ai arămasă, ca tu giocu ti părmănai,
cu mutrerea a ta umplut cu muşteț și buneț,
vrută la mini ñ-ai arămas aşi cum ti am înyisat ca luñicinaț!...

96. Belimaci1) na përgjon nën plloçat e varrit

1.
Porositë prindërore na i ngrenë flokët si gjemba përpjetë,
duke na kujtuar se jemi trima pa shoq e plot ndershmëri,
me histori lavdimadhe si edhe të tjerë popuj me mirësi,
që zemrat e shpirtrat forcë e tyre na i frymëzojnë për jetë.
2.
Ndaj, arumunë, duhet ta kuptojmë sot në së thelli qartësisht,
jo vetëm porositë si darovë e vyer e prindërve tanë bujarisht,
por të rendim si makina garash sot nëpër pista çmendurisht,
kohën ta rrokim për krahësh e pas mos mbetemi përjetësisht.
3.
Për ne arumunët e sotshëm le të jetë ky i pari vrapim,
në të mësuarit e së bukurës, bukuroshezëzë arumanisht,
që të mos e lëmë të humbë, të heshtë, të bjerë në harrim,
siç humbin udhëtarët nëpër rrugët e zgjatura pafundësisht.
4.
Për këtë rrugëtim të mbarë jemi tamam në kohë ne sot,
dhe mundemi t'ia arrijmë porosive të prindërve tanë,
përndryshe prej mallkimesh të tyre prindërore dhënë në prag,
se, që nën plloçat varesh, na përgjojnë Belemaci me ta tok!...
1) K. Belemace , poet i madh arumun

96.Belemace ți ni ascult di sum plocili di mărminț!...

1.
Dimăndarea părintească ni îl'i scoală perl'i di în cap,
că ni amintești că him armâñ gioñ mulț tiñisiț,
cu istori alăvdoasă, ca și alanț mileț cu ghiuneț,
ți cu forța, imnili și sufliții'i a noșț ni îl'i înțap.
2.
Ti ațea, armâñi, lipseești s-aveam nuntru la noi,
nu singur dimăndărl'i mintimeni di a noșț părinț,
ma s-avrapăm ca machinăli din gara di astădz la pișț,
s-îl'i u acățăm chiroulu chirut și nu s-arămănăm dinipoi.
3.
La s-hibă ti noi armâñl' di astădz prota avrapări,
învățarea a mușatil'ei, mușatușa armâneești,
ți s-nu s-alăsăm s-cheară, s-tățătească, s-cadi pi agirșiri,
ca cum chear imnitorl'i pit căl'uri cu multu inșiri.
4.
Ti aistă a noastă cali ambară, tru chirou himu astădz,
putem s-îl'i u agiungiem dimindarea dit a noșț părinț,
al'ura vă s-ni acaț bălsteml'i a lor, data pisti pradz{16},
stog cu Belemace ți ni ascult di sum plocili di mărminț!...

97. Djepi

1.
Gjithsecili prej arumunëve e arumuneve të sotshëm,
jemi përkundur nga nënat tona si zana plot me dashuri,
në këta djepe të lashtë, gdhendur mjeshtërisht me bukuri,
me dru ahu nga duart e mjeshtërve arumunë të Grabovës.
2.
Ky djep tek thanollarët, atje sipër në krye të fshatit
i heshtur qëndron varur përmbi trarët prej pishe përsëri,
si shenjë e rrallë e voglisë sonë, qysh kurrë të lënë pas,
duke na ndjellë si dikur heshturasi të gjithë ne me dashuri.
3.
Tek të vështroj duke qëndruar, varur në ata trarë të fortë,
sepse edhe jeta arumune është tepër e modernizuar sot,
dhe për të porsalindurit ka mjete të tjera për t'u përkundur,
ti o djep, do të mbetesh përherë nëpër ëndrra i dashur!...

98. Mendimet

1.
Ç'dreq ka ky truri im, që më është mbushur plot trazime
dhe ndizen si zjarr i përflakur që vjell flakë pa pushim,
e përflakur në të kuq, hedh nëpër qoshet e saj veç shkëlqim,
duke më treguar sa vojtje mbartin të rëndat mendimet time!?...
2.
Nga s'po ma shtyjnë të ngratën imagjinatën time të thellë!?
Ndonjëherë më shkundin syresh, si pemët prej erës së lehtë;
ndonjëherë tjetër dehem, si i dehur në dasmat plot gëzim,
duke m'i përndarë mendimet e mia nga lumturia pambarim.
3.
Ç'dreq kam që s'i qetësoj dot që ato të rriten pa pushim,
brenda më janë përplasur, duke ma rrëmbyer gëzimin tim,
ndërsa si udhëtarët prej lodhjes, vrapojnë për pakëz pushim,
të mos vdesin kurrë futen, fshihen thellë në shpirtin tim!?...

97. Sărămănița

1.
Astădz caişunu di noi armâñl'i şi armâncăli
him ligănat di la vrutili dădi a noasti ca dzăni,
tu aisti sărămăniți, adărat muşaț, muşaț,
dit mastril' armâñ grevăñoț cu lemn di fadz.
2.
Ninca aco, tru casa la ahurhita a hoar l'ei la thanollarl'ă,
sărămănița şadi spindzirat pi potñă di dzadă robil'ă,
ca semn a ficiuramil'ei, ți di când u alăsăm dinăpoi,
angănăndalui tățoasă cu dor la tuț noi.
3.
Tri mutreascu că ş-astădz stăi pri potñă spindzuraț,
că ş-bana armăñlor easti multu moderinizaț,
şi ti cât amintații sunt alti hălăț ti ligănari cu dor,
tini sărămăniță nu vă s-ti aspardz, vă s-ni arămăñ tu yisoñ!...

98. Minduerili

1.
Ți drac am, ți mădua a mea ñ-easti umplut cu cărteri,
şi s-aprindi ca foc flacuos di iu s-vomu fără căpăsiri pirăli,
arucăndalui luñinii aroşoasi la cohil'i a l'ei,
spunăndalui cât pidimo port minduerili ahăt grei.
2.
Pi iu nu ñi opunai ahăndăsa fănărusira a mea, măratli eali!?
Cât vărnoară mi scutră dit năsi, ca vintlu poñili di aralăli,
cât vărnă oară altă mi îmbetu, ca mbitaț' pit numț hărisiti,
dispărțăndalui dit a hăraul'ei aisti minduerli nidănăsiti.
3.
Ți drac ñă am ți nu mali tățitescu dot s-crescu, pri eali
nuntur ñi sunt hipti şi ñ-au arăchit întreagă haraua ş-dor
ca cum imnitorl'i, dit acurmarea, cu avarapu s-duc ti isihi,
ascumti tru ahăndaua a suflitlui a ñeu, ți putei s-nu ñi mor!

99. Mërzitjet

1.
Ditë e natë më ndjekin këto mërzitje të urryera të pambarim,
por unë kurajoz prej zemrës time të vuajtur, i përzë përgjthënji,
i nxjerr jashtë prej meje, si send të panevojshëm, fare pa vlerë,
ndryshe më prish rehatinë e më zhyt në të këqija e dëshpërim.
2.
Pastaj shkoj andej nga të çojnë vetë këmbët e mia paditurisht
e fytyra më shndërrohet në pamje të shpërfytyruar krejtësisht,
ndërsa i rrëzuar për tokë si i dehur para vahut, duke kërkuar kalim,
nga sytë më s'mund t'i mbaj rrjedhat e lotëve në dëshpërim
3.
dhe siç jam i shtrirë, sa gjerë e gjatë, duke u puthur me token,
dua të ngrihem, por s'mundem dot ta heq vallen çmendurisht,
ndërsa ndërgjegja ime e mjerë është zhytur në zbraztësi tërësisht,
që të mund të bëj mirësi dhe punëra të mbara tok me shokët.
4.
Ashtu të mbushur plot mërzitje kemi mbijetuar të ngartët ne,
nga to dua të largohem, pa më parë askush shpejt e vjedhurazi,
të rend si i lojtur nëpër sheshet paanë duke shkelur heshturazi,
me këmbët e mia bërë copë-copë, nga vrapim im si kalë pa fre.
5.
Të arrij te të dashurit e mi, që po më thërrasin tok të përmalluar,
duke lozur si ndonjë i pangopur, t'ia marr valles edhe njëherë,
duke e dërguar me dashuri gëzimin dhe mirësinë derë më derë,
që të ndizen shpirtrat e atij fshati të mbarë si zjarr i flakëruar…

99. Murzerărili

1.
Noapti-dzuă mi urmedză aisti urutli nibitisiti murzerărili,
ma mini, cu curaj totnali dipărtedză dit imima suferită,
li scot nafoară dit mini, ca vărnă țivea giabă, dip nivrută,
al'iura ñi s-aspardzi rihatea a ñia, ți mi hidzi tu arăli.
2.
Dapoia neg di cât iu mi duc cicioarăli, fără di știeari,
și fața a mea s-alăxeești tu videari multu aspartă,
cădzut împadi, ca vărnă îmbitat, ți cafti cali disfaptă
multu dispărat, nu pot s-îl'i țăn lăcrăli ți ñ-easă dit ocl'i.
3.
Și cum eascu tesu împadi, anda baș locu, cât lung-alarga,
voi s-mi scol pri cicioari ta s-gioc, ma nu mi ñi pot,
încât coșienția ñ-ieasti goală, fără munduiri pri ambara
ta s-feac lucri buni și cât ma multu ghineaț stog cu soț.
4.
Și aveam străbănat noi măraț'l', împlină cu amărziri,
dit ți voi s-mi afuru tățiosu di nividzut di vărnu om,
și s-fug ca ciurtit, pisti pădz călcăñindalui pri loc,
cu ciiorl' a ñei faptă bucăț-bucăț, dit lunga cărțăniri.
5.
S-agiungu ningaună oară la vruț'l'i, ți ma mi strig stog,
ta s-l'eau gioclu, giucăndalui ca nifăntit vărnă oară,
părtărcundalui haraua și ghineți la cafi ușă și obor,
ți si s-aprindă sufliț'l'i ca piră focuoasă ali ambară hoară.

100. Dashuritë

1.
Që kur rrash ndërmend në fëmini, shumë kohë më parë,
më rrëmbyen dashuritë, e prej tyre kurrë s'shpëtova dot,
vrapova duke i ndjekur pas si dhëndëri krushqit gazplot
por s'munda t'i ndaja, në ishin shenjë e dashurisë së saj.
2.
Fillimisht dashuria më përplasej mbi këdo nga të afërtit e mi,
ndërsa pastaj duke u rritur kthjellohej e mbushej plot dëlirësi,
në ndërgjegje përzgjidhte për kë ishte ngjizur ajo dashuri
dhe të përkundej si djep me ëmbëlsinë e saj përgjithënji.
3.
Edhe pse jam përpjekur të qëndroj te ndonjëra e të ngre fole,
por zemrën s'e kam pikasur të rrah ndonjëherë në gji aq fort,
ndjek rrugëtimin duke mos pyetur për durimin që po më sos,
e shoh afrimin e saj, duke ma mbushur jetën si enë uji në zheg.
4.
E di, nëse do të shtie dashuri me bukuroshëzen si zanë mali,
pa hequr dorë kurrë nga hiret e saj, do ta ndjek me besnikëri,
se jam arumun trim, që s'e shkel fjalën edhe nëse jeta i sos,
dhe shëndetshme të ecë rrugëtimin, lidhja jonë se s'ka mort.
5.
Merrmëni e shkundmi ju dashuritë e mia nëpër gëzime,
siç shkunden pemët prej erës malore mes fishkëllimash,
se jam mbushur e s'dua t'i shpëtoj dashurisë plot ledhatime,
dhe shpjermëni nëpër vise ku s'rreshtin melodi bilbilash!...

100. Vrearli

1.
Di când gădzui pri minti dit ficiurami, nânti di multu chirou,
vrearli mi arăchiră și vărnă oară dit eli nu ñ-scapai dot,
după năsi alăgai s-îl'i îngănu, ca cuscrăl' dit harambou,
ma cu de-averu nu putui s-l'i împarț, că sânt semñi di dor.
2.
Nânti vrearea ñă s-păscănea pri la apropoasl'i a ñei,
încât dapoia, anda mi crișteam, s-fățea cama curaț,
tu coștință ñă s-alidzea că tră cai ea eara destineaț
și tră totna s-lăngăna ca tu sărămăniț tu dulțea a l'ei.
3.
Ș-cățe escu ciucutit tu viață s-stau pri vărnăună di năsi,
ma inima nu îl'i u am acăchisit s-ñă băti vroară sum cheaptu,
imnu pi cala a l'ei, nintribat di când ma ti așteaptu
aduchescu ațea apruachari, s-ñi umpl'i bana ca apa tu văsi.
4.
U știu, că eu ma băgai vreari la mușatușa ca dzănă,
vă s-neg dupu ea cu pisti, ni mutat mănă di năsă putei,
că escu gioni armân, ți zborulu dată ș-mortu îl'i u țănă,
și săntoasă s-hibă imnarea a noastă, tu lungu calea a l'ei.
5.
Harauli mări, luațmi, scutrațmi voi a meali vreari,
și ca cum s-scutăr poñl'i dit vintu ți sufi pi munț,
că escu umplut și nu voi s-l'i scap di doruli mușati,
și mi aduțeț la locuri iu nu taț cântăcl'i birbil'i boațăvruț!...

101. Dëshpërimet

1.
Dikur në fëmijëri dëshpërohesha më shumë se shokët e mi,
se e ngrata nënë s'mi plotësonte teket e mia krejt të kota,
ndërsa si fëmijë inatçor, rrihja tokën me këmbë e mia të forta,
dhe pushoja, kur i ëmbli gjumë më rrëmbente si gjithënji.
2.
Vitet e jetës time kalonin pareshtur kurrë njëri pas tjetrit,
ndërsa unë rritesha dhe bëhesha më i pjekur se moshatarët e mi,
dhe me vështrimin realist po i vëzhgoja ngjarjet për çdo gjë,
duke përzgjedhur bukuritë, mirësitë pa dëshpëruar nga asgjë.
3.
Ngandonjëherë vetes time i bëja shumë pyetje heshturazi:
"Pse dëshpërohesh tani, që je rritur e bërë burrë aq i fortë?"
Dhe mbasandaj përsëri po unë i përgjigjesha papritmazi:
"S'pushohen si dikur se sa e sa u përpoqën, por më kot!"
4.
Duke u menduar që t'i jap pyetjeve shpjegime më të qarta,
që më rrahin pa pushim si çekiç gjigand mbi trutë e kokës,
të zezat, gënjeshtrat e bëra nga njerëzit e thjeshtë pa dashka,
e ndryshe pangopësia e politikanëve në qylin thelës së tortës.
5.
Përnjëherë nga toka u ngrita si lojtur e fortë duke thërritur:
"Ç'prisni o arumunë të nderuar, të zgjuar e trima të harbuar,
merreni në duar tuaja të forta të ardhmen për ta shpëtuar,
nga hajdutët, që s'pyesin për ju e që kurrë s'kanë të ngopur!..."

101. Dispirărili

1.
La ficiurami, cai ști cât ori, mi dispiram ma multu di soț,
că măratea iată nu ñ-îl'i umplea căftărili a ñia di încot,
și hiptu tru inati di ficiuriț, ciciorl'i li păscăneam pri loc,
și li chiundream atumțea când mi arichea dulțosu somn.
2.
Añil'i a baniłei ñi trițea unu dupu alantu fără căpăsiri,
încât mini crișteam, cama coptu mi fățeam di a ñei vrăș{16},
și cu mutrerea reală ma îl'i videam undzearăli dit țivăr,
alidzăndalui mușteți, ghinești fără dispirări.
3.
Ali vetea mea, pi apusea cât vărnoară i fac ăntribari:
"Cățe ti dispiredz tora, ți eșț cărscut mari, bărbatoț?"
și dapoia năpoi eu l'i răspund cu niaștăptari:
"Nu s-aștergă năintili, cățe cât și cât s-cilistisiră, ama încoț"
4.
Minduindalui s-li daua a întărbărilor spiegări cama cistiti,
ți mi batinescă totna aisti întribări, ca cioc ghigand în cap,
lăiați, minciuniri ți fac oamñil'i di arada fără vreari,
al'iura dit ațel'i cu coștiență dit politiceñ, ți vor s-scap.
5.
Diunoară mi scol dit împadi ca orbu și cât pot, zghilescu:
"Voi tăñisiț, gioñ, mintimeñ armâñ, ți aștăpteaț,
loțlu tru măñl'i a voasti săntoasi yinitorlu s-u scăpaț,
di furil'i, ți nu întreab ti voi ș-putei nu s-fântescu?!"

102. Gjuha jonë

1.
Gjersa zemra të na regëtijë në gji,
mësimin e saj do ta kërkojmë gjithënji,
edhe brezi i ri, siç bëmë ne gjer tani,
se kështu do na çelet rruga plot mirësi!...
2.
Ndaj ju arumunë mësojeni gjuhën tuaj,
se atëherë Belimaçe me zemër atërore,
nën plloçat e varrit do të prehet i gëzuar,
siç ka ëndërruar te "Porositë prindërore"!
3.
Edhe pse ky rrugëtim është plot vështirësi,
por ca nga ca ne do ta mësojmë me dashuri,
porositë atërore na thërrasin gjithmonë,
jetë e mot ta mbajmë gjallë gjuhën tonë.

103. Si mund mos më marrë malli

1.
Për çdo ditë, kur dal për të bredhur kryeqytetit anë e mbanë,
nga zhurmat e makinave veshët më rëndohen pa pushim,
ndërsa tymi i rënduar nga bloza më përplaset në ballin tim,
e si shakuj të helmët na i mbufat mushkëritë tejembanë.
2.
Pastajza, si mund mos më marrë malli për ditët e të ritë tim,
kur lug më lug e majë më majë tufat e dhenve shëtisnim,
atje larg, në shumë të dashurën Valamaren tonë majë borë,
dehur në aromëza lulesh e melodiozet tingëllima këmborësh.
3.
Prandaj, sot veç më ndjell e s'më lëshon ky i madhi malli im,
që edhe njëherë nën rrobull e të bëj gjumë te burimi ujë kulluar,
të dehem si atëherë përsëri me ëndrra të bukura plot shkëlqim,
në viset të mia të dashura, nën këto drunjtë të lartë duke pushuar!

102. Limbea a noastă

1.
Până s-nă bat inima tu a nostu sinu,
învățarea și știerea vă s-u căftămu,
cum aveam faptă noi, s-fac ș-bărl'ă năi,
singur ea vă s-ni îl'i dăsfacă bunăli căl'i.
2.
Voi arămăñ, învățaț limbea voastră,
că atumțea marulu Belimace în groapă,
vă s-doarmă isihu somnu sum a lui mărmintu,
așă cum îl'i u ari pistipsit la "Dimindear a părințiloru"
3.
Și cățe aistă imnari easti multu greu,
nihiam cât nihiam vă s-îl'i u învățămu.
dămindărl'i di părinț ni strigu, ni strigu,
yii limba a noastă s-u ținemu!...

103. Cum s-nu mi l'ea doru

1.
Când esu dzuă di dzuă nafoară, ta s-alagu pi Metropolu,
urecl'ăl' ñă s-îngrecă dit aurrarăli di machini, nimusurat
încât fumu, îngărcat cu bloză, ñi s-păscăneești tu frămț,
dit ea ca foal'i fărmăcati ñi s-umplu hicațl'i a noșț di arău.
2.
Dapoia, cum s-nu mi l'ea doru tră dzăl' a tinăramlei,
când alăgam cu turmăli di oi vali di vali ș-dzeñ di dzeñ,
aco diparti, la vruta pisti vrută fără soață a Valamarlei
îmbitat cu ñurizmi di lilici și arsunarea mușaț di clopțeñ.
3
Ti ațea, astădz mi îngănești și nu mi sălghieești a ñeu dor,
că nicaună oară sum robul s-mi acaț somnu pingină șopor,
l'a s-mi îmbet ca atumțea năpoi, cu yisi mușaț di gioñ
la ațeali locuri a ñei vruț, șădzundalui sum mușațl'i poñ.

104. Nëse do të marrë malli mos mu dëshpëro

1.
Pak nga pak po më ikën jeta, si të gjithë në këtë botë,
siç ikin mjegullat përmbi malet e lartë pa pushim,
por dhemburitë, që më djegin si prush në gjirin tim,
ndërsa ato duan të vallëzojnë përmbi sheshe gazplotë.
2.
Moj dashuria e jetës time, tek të ëndërroj ty shpeshherë,
i bindur se do ta mbash ndezur si zjarr këtë flakërim,
se s'përsëritet, dashuria e vërtetë mbeten në jetë përherë,
të tjerat jesin pas bosh, humbasin përgjithmonë në harrim.
3.
Që po më afrohet e pazëna me gojë e ndjej qartësisht,
por nëse do të marrë malli për mua mos mu dëshpëro,
përkundu nëpër kujtimet dhe ëndrrat e tua butësisht,
mes tyre do më gjesh e pastaj gjumi të të marrë përsëri.
4.
Por nëse ma sjell jeta që të jes pas teje fillikat i vetmuar,
nëpër rrugë, gardhe e pragje do të zvarritem i përmalluar,
me porositë e tua të dashura mbushur plot me të rrallat bukuri,
të ngratat ato në shpirtin tim do pushojnë përherë në qetësi.

104. Macă s-ti l'ea dorulu nu ti dispiredz

1.
Nihiam cât nihiam ma ňă fudzi bana ca tuţ,
ca cum fug și fug negurli pisti a nalţl'i munţ,
ma doril'i, ți ňă ardu multu tu sin, ca jăr,
eali vor s-giocă cu hărisimi pisti pădz.
2.
Anda ti yisedzu multu ori a lea vruta a baniľei a mea,
convins că s-îl'i u ţăň apreasă foculu până s-bitisimu,
că aistă vreari yini singurună oară di de alihea,
alanti arămănu goali, tu agrișări îl'i chiremu!...
3.
U acăchisescu că ma ňi s-aproachi niacăţata în gură,
macă s-ti l'ea dorulu ti mini nu ti dispiredz,
legnăti pit amintirli, mușati yisili a tali, ți tircură,
că la eli vă s-mi află, dapoia năpoi tru somn s-cadz.
4.
Ma că aduți bana ți eu s-arămănu după tini singur,
vă s-mi strag pit căl', pit porţ, pit gărdz ș-pit pradz,
cu dimăndărli a tali vruti, umpluti cu mușuteţ,
mărătăli di eli, totna vă s-arămăn tu suflitu a ňeu.

105. Me shpirt të përflakur

Kam ardhur me shpirt të përflakur,
mbushur me mall, mbushur me dashuri,
ç'të bëj i ngrati rrëzuar përdhe,
i shtrirë,
si ndonjë kërcu i porsa prerë në pyll.
Dua të thërras sa të mund me zë gjer në qiell,
se arumunët janë kredhur në dëshpërim,
varfëri,
s'po gatiten për të nisur rrugëtimin e ri,
po zvarriten si krimba të pështirë përmbi tokë…

Por ata s'friksohen nga këto kobe të zeza,
s-rrëzohen përtokë si drunjtë e lartë në pyje,
sepse sot ata janë zgjuar si popujt e tjerë,
duke dhënë besën të fitojnë
dhe ta mbulojnë atdhenë me mirësi.

Dua të thërras sa të mund me zë gjer në qiell,
se arumunët janë zgjuar,
po gatiten për të nisur rrugëtimin e ri,
gëzimplotë se nuk zvarriten më,
si krimba të pështirë përmbi tokë…

105. Cu suflitu focuosu

Am vănit cu suflitu focuosu,
umplut cu dor, umplut cu vreari,
ți s-fac măratulu cădzut împadi,
tesu,
ca văr căciub til'at dit păduri…
Voi s-aurr până pi ți̧er cu marea boaț,
că armâñil'i sănt dispiraț,
oarfănaț,
nu s-părgătească ti luari imnari nali,
ma s-astragă ca ierñi pisti loc…

Ma năș nu s-frixi ti aisti l'ăiaț,
nu s-srupaț împadi, ca lemnu analț di păduri,
că astădz sănt diștiptaț, ca alț mileț,
ar data pistea ta s-amintaț
și s-u amvlescă patria cu ghineț.

Voi s-aurru până pi ți̧er cu mari boaț,
că armâñil'i sănt diștipteaț,
ma fac gata ti luari căl'uri năli,
hărisițvi, că nu ma s-astrag ma,
ca yierñi livoasi, uruț pisti loc!…

106. O trim, që e heq vallen aq bukurisht!

Sipas një kënge popullore arumune:
"O bilbil, që këndon aq bukur
të më sjellësh mua dru të thatë!..."

O trim, që e heq vallen aq bukurisht,
porsi ndonjë kërcimtar mbi kashtë bari ,
të më rrëmbesh vashëroren dashuri
e ku shkel më shoqëron dhibsurisht!...

O trim, që këndon aq mjeshtërisht,
si bilbil mëngjeseve në vgjerërisht,
e më magjeps me zë tëndin aq bukur,
si të shtrenjtat nëna në djepet dikur!...

O trim që mbi degë lodron aq bukurisht,
nëpër livadhet bar plota e të pa korrura,
si zogu krahëshkruar fluturon hijesisht
e shpirti ndjell gaze rinore të pasosura!...

Tiranë, 14.03.2010

106. A lăi gioñi, ți giocaț ahăt muşaț!

După cântcu popular armăn:
" A lăi birbilu, ți canț ahăt muşaț,
s-s-ñ-aduț a ñia lemñ uscaț!..."

A lai gioñi ți giocaț ahăt muşaț,
canda vi ansăraț pisti pal'i uscaț,
ta s-ñ-afuri featățeșța vreari,
ți cu dor piu calț ti părmăneaşti!...

A lăi gioñi ți cântaț ahănt muşaț,
ca birbil'iu tu păduri di cu dimnaț,
cu muşta boați ni alsaț chiundusiț,
ca scumpa dada tu veacl'ia sărmăniț!...

A lăi giuñi ți giucaț ahăt muşaț,
lalivădzăli iarbi-mplini nisățiraț,
azbori ca pul'iu areapti-muşaț
și tu suflitu ñ-aduț hări di tiniraț!...

Tirana, la 14.03.2010

107. Gëzohem se ndodhem këtu mes jush

1.
Ashtu siç kam ardhur edhe unë nga një vis largët,
në këtë qytet metropol të Shqipërisë tonë të shtrenjtë,
jini mbledhur edhe ju kolegët e mi nga të gjitha anët,
në këtë shkollë e të re si nuse këtu në Sauk të vjetër.
2.
Cilido nga ju është ngarkuar e mbart në shpirt të tij mall,
për viset tuaja, aq të bukura të lëna bosh fare pa njerëz pas,
mbetur të bukurat kodra e luadhe, pa tingëllim këmborësh,
nëpër oborre e sheshe asnjë fëmijë s'loz më me shok të moshës.
3.
Prej viseve tuaja keni sjellë këtu nga një copë bukuri të rrallë,
por edhe zanatet e trashëguar prej prindërve tuaj të mençur,
duke i lënë pas bukuroshëzet këngë lindur nëpër strall,
tok me dasmat e zjarrta shqiptarçe me dollibash si dikur.
4.
Ndërsa në mesin tuaj ka edhe talente vërtetë të zgjedhur,
që e heqin vallen shtruar e këngën ngadalëza e me ëmbëlsi,
sikur shkelin mbi shtroje të pambukta, shtruar me aq bukuri,
e sikur dalin prej shpirtrave të tyre pa pushim mall ndezur!...
5.
Gëzohem së tepërmi se ndodhem këtu mes jush fatmirësisht,
jo vetëm si shokë vallëzimesh, por edhe si kolegë të dashur,
por edhe shëmbëlltyrë për nxënësit tanë ende të papjekur,
ndaj dua që këtë ditë ta festojmë gjer në dehje bashkërisht!...

107. Hărisescu că escu astădz, aua nemsa di voi

1.
Și cum am vinit ș-mini dit multu diparti,
tru aistu căsăbău metropol ali Arbinișì a noastă,
hiț adunat ș-voi coledz a ñeii dit tuti părțili,
la Sauc, tu aistă școală vecl'i ș-nauă ca înveastă.
2.
Cafișunu di voi esti îngărcat și poarti tu suflit a lui dor,
ti locuri a voasti mușaț, alăsat gol' fără omñ dinăpoi,
arămasăr mușatili dzeñ și livadz, fără clopț di oi,
pit oborl'i ș-împadz niți un cilimen nu giocă cu soț.
3.
Di a văosti locuri aveaț adusă aua câtună bucat di mușutaț,
ma ș-zănăț, purtat la voi dit a voști părinț învățaț,
lăsăndalui mușatili, mușatușili canț dinăpoi,
stog cu arbinișască numti, cu gioț ș-cu toast soi di soi.
4.
Încăt namsa di voi sănt multu di ațeal' talenț alepș,
ți li trag giocu aștirrat și cănțili dulți pi anarga,
canda calcu tu bumbac aștărat pi a lunga ș-pri alarga,
și ți easă dit sufliţl'i a lor cu marulu dor ca foț apreș.
5.
Hărisescu multu că escu astădz aua, nemsa di voi,
coledz năi, vruț ca soț ș-coledz, nu singur pit gioț,
ma și yrneci buni ti elevil'i a noșț, ninga nicopț,
ti ațea aistă dzuă s-sărbătorim și s-ni îmbităm stog noi!

108. Shokët e mi të Elbasanit

1.
Sa më mungoni ju shokët e mi të Elbasanit, të kohës së shkuar,
që sapo dal prej të ngrohtës dhomë herët në mëngjes vërdall',
ndërsa shkoj te kafeneja në mes të mëhallës krejt i vetmuar,
zë e pi lëngun e saj ngrohtë, duke kujtuar të shkuarën me mall.
2.
Aty i sjell ndërmend të bukurëzat ditë kushedi sa e sa herë,
të përjetuara këtu në Elbasan, bashkë me ju aq ëmbëlsisht,
te kafeneja në udhëkryq të Pazarit të Vjetër, tok si atëherë,
ku të gjithë i shtjellonim pa pushim bisedat tona shpejtësisht.
3.
Sa më gëzoni ju shokët e mi të dashur të qytetit tim Elbasan,
ndërsa papritmazi mua të ngratit më darovitni me plot mirësi,
e duke bashkëbiseduar, më kridhni të ëndërroj me largpamësi,
për të mirët bij të shpërndarë anë e mbanë botës si emigrant.
4.
Pastaj mbyllim debatet me pandehma të bukura si të ndonjë përralle,
se rishmëzi do të vijnë tek ne shpresëmëdhatë e gazmoret ditë,
që me mall të madh ne i kemi ëndërruar kaq gjatë shpirt dëlirë,
që quhen liri e vërtetë si ditë e shenjtë e së Enjtes së Madhe[1].

[1] *E enjte e Madhe në javën para Pashkëve të Mëdha*

108. Soțl'i a ñei dit Ñocas

1.
Căt ñi am dor ti voi soțl'i a ñei dit Ñocas cu ilichia nău,
ți când esu tahina di la căldurăoasea casă astădz,
încăt singuros mi duc la căfeneia, namsea dit măhălău,
iu anda amintescu tricutu, acaț s-beau dzama a l'ei cald.
2.
Aco l'i aducu tu minti caişti căt ori muşatili dzăl',
tricut dulțosi aua Ñocas, dzuuă di dzuuă stog cu voi,
ca atumțea la Împăzare Vecl'iu tu cruțosa di dauli căl',
iu l'i trițeam multu cutroari muabetli fără căpăseari tuț noi.
3.
Căt mi hărisiț voi soțl' a ñei vruț dit căsăbăulu Ñocas,
niaştiptat ñi aduțeț a ñia ahăt mulți hăriați,
cu zburarea stog, mi hidzeț s-yisescu cu mutritea dăparti,
ti buñl'i hil' arăspăndiț pit duñeau ca emigranț.
4.
Dapoia l'i incl'ideam debațl'i cu păreari muşeati,
pistipsim că va s-yin dzălili îngărcati cu hărisimi,
ți sunt înyisat noapti-dzuuă ahăt multu cu dor di tuț noi,
ți s-încl'eam libertati di de alihea ca Dzuuă di Mari Gioi [1].

[2] *Gioi Mari a Paştului*

109. Përkundet nëpër ëndrra, aq të bukura

1.
Po ç'dreq paskërka ky shpirti im i ndezur sot kaq bukur,
që vetëm se përkundet mes ëndrrash të mbara si purpur,
e i trembur fshihet prej pamjesh të mallkuara me shpejtësi,
në vend t'i godasë me poezi për shpëtim nga kjo fatkeqësi.
2.
Edhe pse vitet po më rrëshqasin e më rëndojnë me butësi,
prapëseprapë s'do që të plaket ky shpirti im në shpërthim,
prapëseprapë më rrjedhin veç vargjet e thurura me adhurim,
për mjekër bardhën time pleqëri duke ardhur me aq thjeshtësi.
3.
Veç për këto kam ëndërruar shumë herë në të rite tim dikur,
që të arrijmë të bashkëjetojmë gjithmonë në kamje e mirësi,
por siç duket për ne të shkretët ajo ndodhet larg e parritur,
pse do të duhet ta derdhim djersën në punëra me vështirësi.
4.
Por ky i përvuajturi shpirti im asnjëherë zjarrin s'e ka shuar,
ai vetëm ka ëndërruar, ëndërron e beson shumë në besnikëri,
se po na afrohet dita e ngarkuar rëndë me bukuri e mirësi,
se po vini të na sillni me gaz lajmin e lirisë duke vrapuar.
5.
Po ç'dreq paskërka ky shpirti im i ndezur sot kaq bukur,
që vetëm se përkundet mes ëndrrash të mbara si purpur,
e i trembur fshihet prej pamjesh të mallkuara me shpejtësi,
në vend t'i godasë me poezi për shpëtim nga kjo fatkeqësi

109. S-leagnă pit yisuri ahăt muşaț

1.
Ma ți dreac avusca astădz aistu apresulu suflitu a ñeu,
ți s-leagnă pit yisuri ambaroasi și vruti muşaț
și s-ascundi cu troară di aspărarea a viderilor bălstămaț,
tru loc ți s-l'i agudeasc cu stihuri ti scăpari dit aistă lai arau.
2.
Şă cățe añil'i ma s-ñi aruchiușescă ș-ma mi fac ma greu,
nica nu va s-auşedză aistu apresu suflitu a ñeu ca foc,
nica ñi vearsă stihuri adăraț muşaț yisi alboş ca neu,
tri barba alboasă a mea, ți ma ñi yini ca muşatuşa di loc.
3.
Tri aisti ñă am yisat multu chirou tu tinăramea a mea,
ta s-agiungem s-bănăm totna cu multu aveari și buneț,
ma cum s-veadi tră noi măraț'i multu dăparti ni ieasti ea,
cățe s-vrea nica s-vărsăm sudoari pi lucruri greiț.
4.
Ma putei nu easti șădut aistu măratulu di suflitu a ñeu,
el singur yiseadză, yiseadza și pistipseași multu la pisti,
că ma s-aprucheași dzua îngărcat cu muşuteț di ambări,
că ma viniț la noi aducăndalui libertatea ca măjdeau.
5.
Ma ți dreac avusca astădz aistu apresulu suflitu a ñeu,
ți s-leagnă pit yisuri ambarosi ahănt multu muşaț
și s-ascundi cu troară di aspărarea a viderilor bălstămaț,
tru loc ți s-l'i agudească cu stihuri ti scăpari dit aistă lai arau.

110. Hajdutët

1.
Shtëpitë e Grabovës "si lule", fshat shumë i njohur në Shqipëri,
ishin ndërtuar me mur guri të bardhë e mbuluar me plloça gri,
ndërsa brenda: si muret, shkallët dhe tavanet me petavra bredhi,
për ngrohtësi e zhurmë, nëse hajdutët vinin t'i grabisnin tinëzi.
2.
Cilido syresh ndjente zhurmën e petavrave të thata prej bredhi,
lëshonin kushtrimin për ndihmë nga fqinjët e tyre me shpejtësi,
atëherë kuptohej se hajdutët ishin futur në të vjedhin bagëti,
po s'mundnin se rruheshin nga grabovarët syçelur me xhelozi.
3.
Kështu hajdutët e ndyrë, të mësuar të jetonin pa derdhur djersë,
të uritur si bisha të egra dimrit, planëzonin t'u vidhnin bagëtitë,
por në kurthet e ngritur për ta, pa shpëtim binin gjithnjë,
që ja u prisnin duart vjedhacake për të mos ua grabitur qilarët.

110. Afurl'i

1.
Casăli a Greavil'ei "ca lilici", hoară multu cunuscută tu Arbinişi,
eara construit cu cheatri alghi ş-amvălit cu ploci murgoasi,
încăt nuntru: cum murl'i, scărl'i, aşi ş-tavăñi, cu păturri di bradz,
ta s-li ţinea călduri şi s-arsuna când s-intra afurl'i tu pradz.
2.
Caiţido di năş, ţi avidza arsunărli al pătăvruri uscaţ di brădz,
cutroară-cutroară didea strigara ti agiutari al a noşţ bănător,
atumţea s-duchea că afurli sunt intreaţ tri afureari la chilăr,
ma nu putea că eli să-avegl'ea di gioñ ocl'idisfapţ grevăñoţ.
3.
Aişti afuri lăvoşi, ţi eara învăţaţ s-bănedz fără sudor,
agiuñ ca agârsimi, fiţea planuri lăi s-afura tu hoară,
ma totna cădea tu niascăpaţl'i cerţ, di iu nu inşea vroară,
îl'i u til'ia măñl'i afuraţilor ta s-nu ariche prăvdizl'i a lor.

111. I dashur, ti po vjen prej së largu

1.
I dashur prej së largu, po më vjen ngadalë i zbukuruar hijesisht,
duke shkelur mbi të gurtat rrugë sikur po vallëzon çmendurisht,
ndërsa të të shpreh dashurinë time po të dal para me nxitim,
të arrij e duke të mbartur në krahët e mi, të puth me përmallim.
2.
Ti po më vjen duke fluturuar e kënduar si zogjtë në shtegtim
të takoj veç edhe njëherë atje në Gërgulin ujë kulluar si dikur,
që ta shuaj zjarrin e dashurisë, si etjen tek burimi me gurgullim,
pastaj le të më rrëmbejnë ngadalë ëndrrat e martesës së lumtur.
3.
Ti po më vjen duke shkitur, përmbi lulëzat e bukura me ngadalë,
duke kënduar melodinë e këngës së njohur prej nesh heshturazi,
vrapon përmbi gurishte e gjembaçët përhap pa pushim me krahë,
edhe pse të dhembin, s'pyet prej shpimit të tyre me aq hidhuri!...
4.
I dashur, prej së largu po më vjen ngadalë i zbukuruar hijesisht,
të ma shuash edhe njëherë rrahjet e zemrës sime përmallsisht,
shpejt se po të pres, edhe pse jam bërë porsi një dru i thatë,
si s'plasa kur të pashë të hyje në oborr hipur në kalë të bardhë!...

111.Tini, alăi vrutu, ma yiñ di diparti

1.
Tini, a lăi vrutu ma ñ-yiñ anarga di diparti, adărat mușaț,
cu călcarea greau pisti cheatroasăli căl'iuri canda ma gioț încor,
încăt ț-esu dininti cutroră s-ță spunu cătmultu mi ari loat dor,
s-ti agiungu, s-ti baș cu budzili purtăndalui tu a ñei braț.
2.
Tini ma ñ-yiñ, azburăndalui ș-căntari mușeaț ca pul'i,
s-ti adunu ninga unoară, aco ndzean la mușatulu Gărgul'i,
ta să ñ-apuñ ardoasea a vreariei, ca seta când bei apă la șpor,
dapoia la s-mi arăchească anarga pi braț însuraresсu yisoñ!...
3.
Tini ma ñ-yiñ canda calț anarga, pisti lilici ahănt mușaț,
căntăndalui tățitu melodia cănăscută ghini singur di noi,
avrapeășț pisti cheatri, schiñăl'i li disparț cu a tăi braț,
ș-cățea ti doar, nu întreghi că ti-înțeap cu chipturi a lor.
4.
Tini, alăi vrutu, ma ñă yiñ anarga di diparti, adraț muștaț,
s-ño apuñ ninga unoară băterea a inimniłei a mea di dor,
cutroară că ma ti așteptu, ș-cățea escu faptă ca lemni uscaț,
cum nu cărpai când ti vădzui s-ințără pi calu alb tu ubor!..

112. Më pushtoi dëshira të thur vargje

1.
Qysh së vogli më pushtoi dëshira të thur vargje pa pushim,
njëherazi në arumanisht e shqip për vashëzën shpirtbrisht,
si dhe për dashurinë e pamat për të shtrenjtin Atdheun tim,
ndanë burimesh ujëkulluar e pyjesh të paanë nën bredhisht.
2.
Ku janë përkundur si në djep me bukuri e aq ëmbëlsisht dikur,
nga të dashuruar e të dashuruara në ëndrra të ëmbla për dashuri,
e qëndrojnë ende në këmbë si shkëmbinj që koha s'i gdhendur,
e që na dërgojnë gjer te ne me mall të madh e plot dhembshuri.
3.
Ndaj si ndër ashpërsinë e tyre më është mësuar ky shpirti im,
me pamje të frikshme e të llahtarta erërash uturitëse pa pushim,
që në pyjet hijerëndë, edhe në se bie bore, s'ndalen asnjëherë,
me to ta nxjerr mallin e ta hedh vallen çmendurisht si atëherë.
4.
Pastaj le të më rrëmbejnë të ëmbël-bukurat ëndërrime rishmëzi,
le të bije, të përplasem përdhe si vjeshtës së vonë gjethet e thata,
të kthehem përsëri për ta hedhur vallen tok me trimat shtruarazi,
se jam lindur veç për gëzime e mbarësia plot ledhatime të gjata!

Tiranë 02.09.2006

112. Mi arăchi vrearea ti adrari stihuri

1.
Dit tru ñicurami mi arăchi vrearea ti adreari stihuri fără căpăsiri,
diunoarea pi armâneești ș-arbiniseești ti featița suflitu moali,
încăt ș-ti vearea nimusurată ali scumpa patria a mea Arbinișì,
aco ningă șopori cu api cureati și păduri di brădz, fără pontñi.
2.
Iu sănt lăgănati nănti ca tu sărămăniță ahăt noastimi și mușeaț,
dit vruț și vruti în dulțl'i yisuri lundz di vreari ația sum poñ,
ți s-ținu ș-astădz sculaț, împroasț ca cheatri mări pit agrăl'i chiroñ,
ți ni pătreac cu maru dor aua la noi bană umplut cu ghineaț.
3.
Ti ațea ca tu agrisimi a lor ñ-ieasti învățeat suflitulu a ñeu,
cu mutriti fricuoasi dit frundzearăl'i ahănt lăftărăoasi di vinț,
ți tru aisti păduri aumbrimări nu căpăseascu ș-candea s-da neau,
cu eli voi s-îl'i u socot doru a ñeu, s-gioc încor ca ciurtiț di minț.
4.
Dapoia la s-mi arichească năpoia tu dulțu somn mușeațl'i yisoñ,
la s-cad ș-s-mi păscăneascu împadi ca frăndzli dipi poñ uscaț,
ș-la s-mi șuț la năsi ninga unoară ta s-gioc încorulu di gioñ,
că eu eascu amintat singur ti hărăuri ș-ti lăngăneari îmbraț!

Tirana, la 02.08.2006

113. Monologu i një të varfëri

1.
I rrokullisur, i shtrirë si ngordhësirë përtokë,
përplasur në të pështirat e hedhura qoshe më qoshe,
i vetmuar, pa të mirët shokë,
fare pa miq,
i shtyj ditët i zalisur,
i goditur rëndë prej varfërisë,
i rrëzuar teposhtë
si ndonjë krimb i kredhur në farmakurina…
2.
Zvarritem nëpër udha pa dal'e,
si ndonjë hije e ngjyer krejtësisht në të zezë:
së brendshmi tërësisht i trembur,
ndërsa së jashtmi komplet i zverdhur,
duke shkitur ngadalazi si ndonjë i paditur,
i vetmuar pa të afërmit e mi të shtrenjtë,
kredhur në varfëri…
3.
Shpesh e pyes veten time heshturazi,
ç'të bëj, si ta zboj këtë varfëri,
që po më tret dita-ditës pa pushim,
porsi një qiri që digjet pranë varrit,
duke ndjellë qasjen e të zezës vdekje,
që të përshpejtojë ardhjen sa më të shpejtë,
për t'i shpëtuar kësaj varfërie të urryer…

113. Monologu a unui oarfunu

1.
Arucutit, aştrat ca psohiu împădz,
păscănit lăvosiñl'i arucati chioş di chioş,
singurosu, fără buñl'i soţ,
fără oaspiţ,
trec dzălili zilipsit,
agudit greu di oarfănaţ,
cădzut înghios
ca vărnă yiermu hiptu întru amarriñ…
2.
Mi strag pit căl'ăli fără di inşirii,
ca vărnă aumbră întreagu cu lai buisit:
nutru tu mini întreagu aspăratu,
încăt nafoară di mini întregulu gălbănit,
arruşchindalui anarga ca vărnă neştiutu,
singurăoasu fără scunchil' apropiaţ,
hiptu tu oarfăniţ.
3.
Mi întreabu pri vetea a mea tăţităoasu:
ţi s-fac, cum su ñ-azguñeascu aistă oarfăniţ,
ţi ma tucheaşti dzuuă di dzuuă fără căpsiri,
ca vărnă ţeară ţi s-ardi ningă mărminţ
îngănindalui apruchearea ali moarti,
ta s-ňă yină căt cama troară
şi s-ni scap dit aistă urută oarfăniţ…

4.
I rrokullisur, i shtrirë si ngordhësirë përtokë,
përplasur në të pështirat e hedhura qoshe më qoshe,
i vetmuar pa të mirët shokë,
fare pa miq,
i shtyj ditët i zalisur,
i goditur rëndë prej varfërisë,
i rrëzuar teposhtë
si ndonjë krimb i kredhur në farmakurina…
5.
Përsëri, po unë përgjigjem nga së thelli heshturazi:
s'kam ç'të bëj i ngrati unë,
edhe pse s'po e gjej dot udhën e drejtë,
për të dale në dritëzën e jetës mbushur plot mirësi
dhe të eci mes tyre pa pyetur për varfërinë,
së toku me shokët e mijë të fëmijërisë,
t'u rrëfej të gjithëve në këtë botë,
sesa shumë e dua jetën…
6.
Kështu, skëterrë, gjer më sot e kalova këtë jetë,
por tani e tutje do ta shkoj në mirësi,
sepse dita-ditës do të zihem me të,
duke dashur ta godas me grushtet e shtrënguar
plot djersë,
gjersa së toku me shokët e mi,
të arrij edhe unë jetoj i gëzuar si ata…

4.
Arrucutit, aștrat ca psohiu împădz,
păscănit lăvosiñl'i arucati chioș di chioș,
singurosu, fără buñl'i soț,
fără oaspiț,
trec dzălili zilipsit,
agudit greu di oarfănaț,
cădzut înghios
ca vărnă yiermu hiptu întru amarriñ…
5.
Ma năpoi eu mi răspundu dit ahăndaua tățitoasu:
nu am ți s-fac măratulu di mini,
ș-cățe nu ma aflu cala di îndreptaț,
s-easu tu luñina a viațiîl'ei împlină cu ghinaț,
și s-imnu pi eali fără s-știu ti oarfăniț,
diadunu cu tuț soțl'i a ñei di ñicuriț,
ta s-îl'i u spunu a tuțlor tu aistă duñai,
că cât multu bana ñ-îl'i u voi…
6.
Di aua ș-nănti și ñi-u tricui aistă bană lai,
ma di aua aș-înclo vă s-ñi u întrec bana cu ghineț,
că dzuuă di dzuuă vă s-mi acaț cu ea,
voi s-lo agudescu cu bușl'i strimță,
umplut cu sudoari,
păn, diadun cu soțl'i a ñei
s-agiungu ș-mini s-băneadz hărisit ca el'i…

114. Moj bukur, bukuroshëze

1.
Moj e bukur, bukuroshëza e rënë prej qiellit në agim,
që bredh krenare ngadalë shesh më shesh pa pushim,
sikur do të mos prishësh e të thyesh asgjë në qetësi
veç të përhapësh ngado ndër ne si të mjaltit ëmbëlsi.
2.
Moj e bukur, bukuroshëza, që na e hedh vallen shtruar,
oborr më oborr, derë më derë, shkëlqimtare plot hijeshi,
sikur do të përhapësh ngado shkëlqimin e saj tërë bukuri,
prej zemrash të përflakura prej dashurisë së përmalluar.
3.
Moj e bukur, bukuroshëza, e mbushur plot me dashuri,
që më shket si gjarpër, gjarpërushja përmbi gur e male,
gjersa të gjesh vendin e prehjes mes ëndrrash për lumturi,
e të shpëlahesh nëpër ujërat e kthjelltë nën urat me harqe.
4.
Moj e bukur, bukuroshëza, që mua më more më qafë,
por dua të të mbështjell të tërën me puthje të zjarrta,
që ngjitur pas teje, të bije në gjumin e ëmbël si mjalta,
e pastaj në zgjim të shpëlahem ndër burimet në vapë.

114. Ale muşeată, muşatuşă

1.
Ale muşată, muşatuşă cădzut dit analtu ţer,
ți aladz cu măndăr pri anarga pădz di pădz,
canda vrei ţiva s-nu aspardz, ţiva s-nu frăndz,
singur s-dăsparţ iuțido la noi dulţeama ca di ñer.
2.
Ale muşată, muşatuşă, ți gioţ aştăraţ încor,
luñineaşti cu ahănt muşutaţ la noi ubor di ubor,
canda vrei s-disfaţ iuțido aua la noi luñiñăli,
dit imnili apreasi di dor, ca aroşulu di foţ mări.
3.
Ale muşată, muşatuşă, umplut cu maru dor,
ți ti stradz ca nipărtică, nipărticuşă pisti munţ,
păn s-află locu m-ambăru iu s-apuñ a tăi yisoñ,
s-ti spel pit aţeli curatli api, ți întrec sum punţ.
4.
Ale muşată, muşatuşă, ți mini mi luoş pi guşă,{18}
ma voi s-ti avărtescu întreagă cu başăli caldurosi,
s-cadu tru somn dulţi alichit cu tini, loaţ di guşă,
dapoia când s-mi dăşteaptu, s-ni spălăm la şopori.

115. Peizazh

1.
Moti sa vjen e ashpërsohet, edhe më shumë ndër ne,
qiellit po vallëzojnë të çiftuara retë e ngarkuara rëndë,
çdo gjë dehet nga tendosja e errësirës së natës së gjatë,
ndërsa njerëzia përgatitet ndaj rrebeshit të egër nën re.
2.
Furtuna e egër mbërriti në fshatin mes malesh papritmazi,
e përplaset me çdo gjë, që zë udhën me forcë çmendurazi,
pemët e drurët e lartë prej egërsisë së saj varen kokëposhtë,
si kocka të thyera me vare kërcasin trarët vjetër nën çatitë.
3.
Ndërsa përjashta zogjtë e gjorë së ftohti cicërijnë nga mundi,
se janë të uritur e s'gjejnë thërrime për ushqim gjëkundi,
të uritur e të ngrirë bien e shtrihen përtokë për të ngordhur,
gjersa përmbi bardhësinë borës japin shpirt këngë heshtur!...

115. Peizaju

1.
Chiroulu cât ma yini ma s-fați ma aspărosu aua la noi,
în ţer ma gioacă norl'i negur, îngărcaţ multu greau,
ți do s-îmbeati dit tinderea a lungl'ei noapți cu neau,
încât oaml'i fac hastădzri ti vinerea ali aspăra, furtună sum nor.
2.
Niaștiptat agiumsi furtuna namsa di munți tu hoară,
s-păscănești pi ți do ți l'i acaţă calea cu forţă, ca ciurtită,
di ea, analţl'i poñ și lemñ, capu înghios sunt spindzurăţ,
ca oasi frămti cu ciocu, cărţăneascu sum ciatii vecl'i potñă.
3.
Încât nafoară, ţări pul'i că măraţl'i sufureţă di arcăoari,
că sunt cu foami și iuvea el'i nu aflu sărămi tri mâncari,
dapoia cadu și s-tindu pisti pădz shi supseascămă ngăl'ţaţ,
păn alboasa ali neauă da a lor sufliţ cântcă-tăl'iaţ.

116. Nga s'më kanë çuar këto këmbë

1.
Nga s'më kanë çuar këto këmbët e mia, si shkopinj të thatë,
nëpër ata male të lartë e të pashkelur nga barinjtë asnjëherë,
nëpër ata pyje të paanë e të parrahur nga sharrtarët me sëpatë,
nën retë e rënda nga pikat shiut e breshrit të rënë përnjëherë.
2.
Që nga malet e lartë zbrita gjer anës detit të kaltërosh tatëpjetë,
duke u dehur nga këngët e Shqipërisë së mesme çuditërisht,
ndërsa në Elbasan u ngul famil'a ime grabovare të banoj për jetë,
e më parë se gjithë të tjerët e shtëpisë nisa shkollën dashurisht.
3.
Aty u rrita dalëngadalë gjersa sot jam bërë burrë shumë i pjekur,
pasi mbarova universiteti u laureova mësues i shqipes së bukur,
duke çuar shtëpi më shtëpi e fëmijë më fëmijë diturinë me dashuri,
e duke mbjellë në zemrat e tyre të njoma veç gëzim e lumturi!...
4.
Po kur jetën time të gjertanishme e gjykoj me gjakftohtësi,
gëzohem se ajo mua më ka darovitur me aq shumë mirësi,
turp i madh është të qahem prej bukurive të saj pambarim,
gjithnjë kam rrojtur e do rroj me nder gjer të sos shpirti im!...

116. Pi iu nu mi au dusă aişț ciciorl'i

1.
Pi iu nu mi au dusă aişți ciciorl'i a meali uscaț ca pălenădz,
pit munț analț, nicălcaț putei vărnoară di picurarl'i,
pit păduri fără sinuri și niagrișiț di tăporili al șărtaril'i,{19}
sum neagrl'i și greli di ploai, și-di găruți di grădna măr.
2.
Mi dupunai hima până la margina di mare vintuosă,
mi chiudusi melodia a cănțurilor dit namsea ali Arbinișii,
când la căsăbăulu Ñocas s-stabili fumel'ia a mea gărvăñotă,
iu închisiă ș-mi duș ma nănti di tuț alanț cu chefi la sculi.
3.
Ația cărscuiă anarga-anarga până mi feciu bărbatu copt,
bindăsiă facultetulu și mi laurai dascu ali arbiniseești,
casă di casă pitricui știerea pit ñițl'i la cilimeñi cu dor,
sămnăndalui haraua pit imnăli a lor tinăraști.
4.
Ma când îl'i u giudicatescu bana a mea tricută până aztădz
mi hărisescu că ea a ñia ñi ari fută întreagă cu mușteț,
ma s-mi plăngu di mușteți a l'ei ñi easti arușinaț,
totna am bănat cu tăñii pri ambarea namsa di ghineț.

117. Aty nisën udhëmbarësinë ëndrrat e mia

1.
S'do të më harrohet asnjëherë ashpërsia e pamjes dimërore,
kur në mëngjes vështroja që prej dritares tepër kureshtar,
bardhësinë e borës, tendosur tejembanë si qilim madhështor,
që aty nisën udhë mbarësinë ëndrrat e mia të bukura fëminore,
2.
që vetëm ky shpirti im i përmalluar di t'i rrëfejë aq bukur,
pamenduar se ajo dritare do më ish aq e dashur ndonjëherë,
papandehur se do mbetej në shpirtin tim e shtrenjtë përherë,
nga nisën të më përkundin butësisht dashuritë e mia pasosur.
3.
Që atëherë nga s'brodha nën mbi rrahjet e gjirit me përmallim,
nisa shkollën për të mësuar me dashuri atje në fshatin tim,
pastajza mbarova universitetin, duke u diplomuar në gjuhësi,
ndërsa sot po i thur vargjet me sqimë e mbushur plot mirësi.
4.
Sido që ndodhi me jetën time, mbushur plot ashpërsi,
mbetën ca copëza të dashura të vegjëlisë sime me vështirësi,
të ëndrrave udhëmbarë, nisur që prej dritares dhomëzës sime
tek kjo shtëpizë e vjetër, pranë Lumit të Madh plot vezullime.
5.
Askush s'mund t'i rrëfejë më mirë se përse digjet shpirti im,
kur sjell ndërmend dritarezën e shtëpizës time të shtrenjtë,
se ato pamje, edhe pse i dua, s'mund t'i rikthej qoftë njëherë,
me to të loz e të gëzohem përsëri, si nuses së tij dhëndri i ri!...

117. Ați̦ia închisiră calambar a meali yisoñ

1.
Nu ñă s-agărșeași putei viderea a iarilei aspăroasă,
când di tahina di la pingerali videam curioz nafoară,
alboasea a neauлei teasă ca sazmă iuți̦do pisti loc,
di ați̦ia închisiră pi calambară a meali muș̦ați̦l'i yisoñ,
2.
ți ma și eu poati s-îl'i spun ahânt muș̦ați̦ măratli di eali,
ni minduită că ați̦ea pingieră văroară vă s-ñă iearea vrută,
nipitipsită că vă ñă arămna tu suflitulu a ñeu scumposă,
di iu acț̦ară s-mi leagnă moali-moali vrearăli a meali.
3.
Di atumț̦ea mini pi iu n-alăgai cu aistu maru dor tu siñ,
neș la șculiă a hoarilei ta s-învăț̦ cântari și sciriari,
după mi duș la universitet și mi laurai ti limba arbinăseași,
încăt astădz mali anyrăpăsescu muș̦eaț̦ stihuri cu chischin.
4.
Ghini ma cumț̦ido ți ñi undzi tu bana a mea asproasă,
ñ-armasăr niscânti bucăț̦ vruti dit ñicuramea greau,
dit yisuri, ți loră calambari la ați̦ea pingeri a meua la giuneau,
aistă casa a mea vlecl'i pi nigă Valea Mari nica împroastă.
5.
Nițiunu ma ghini di mini s-spună căț̦ea mi ardi suflitulu a ñeu,
când întru minti aduc a lea pingeri a casiei a mea scumpă,
că ați̦eali viderili ș-căț̦eali voi, nu pot s-l'i toru ninga unoară
cu eali s-gioc și s-mi hărisescu năpoi, ca vărnă harambou!...

118. Vapë që të përvëlon si saç

1.
Në këto ditë vere me kaq vapë të rëndë që përvëlon si saç,
ma do zemra të jem edhe unë atje ndanë krojesh ujëkristaltë,
në fshat me pyje pishash hijerëndë, hala plot e majëmprehtë,
po edhe me sheshe të jeshilët ndanë kodrash me gjembaç.
2.
Oh, i ngrati unë, sa fort më ka marrë malli për ju viset e mia,
paharruar, nga më të bukurit dhe më të shtrenjtit në botë,
ku të endem anembanë me shokët e fëmijërisë sime gazplotë,
te Fëntënelet ta pjek fërlikun e qengjit në prush me shkëndija.
3.
Në këto ditë vere me kaq vapë të rëndë që përvëlon si saç,
ma do zemra të jem edhe unë atje ndanë krojesh ujëkristaltë,
në fshat me pyje pishash hijerëndë, hala plot e majëmprehtë,
po edhe me sheshe të jeshilët ndanë kodrash me gjembaç.
4.
Pastajza le të loz me lloj-lloj lojërash nëpër ato vende plot mall,
sikur të isha edhe njëherë djalosh i dehur nga të ëmblat ëndrra,
të tundem lehtas si në djep, nën hije drurësh përhap vërdall,
e të ngopurin bark me mish fërliku të pjekur ta shuaj në lodra!...

118. Crăoari mari ți ardi ca cireap

1.
Tu aisti dzăli di veară, cu ahănt crăoari mari, ți ardi cireap,
ñi va inima s-eascu și eu aco îndzeană, ningă fântăñ,
la hoară cu păduri aumbrimări di chiñ, cu schiñ ți-înțap,
ma ș-cu pădz mușati, virdzoasi dit iarbă sum dzăñ.
2.
Ah, măratulu di mini, căt mi ari lot doru ti voi yisuri a ñei,
niagrishit, cama mușatli și ma vruțl'i locuri a lumiľei,
iu șopor di șopor cu soțl'i voi s-alag năpoi ca di ñicuriț,
la Fântăneli s-îl'i u frig pi sulă di brădz nimal'iu di ñel'i biț!
3.
Tu aisti dzăli di veară, cu ahănt crăoari mari, ți ardi cireap,
ñi va inima s-eascu și eu aco îndzeană, ningă fântăñ,
la hoară cu păduri aumbrimări di chiñ, cu schiñ ți-înțap,
ma ș-cu pădz mușati, virdzoasi dit iarbă sum dzăñ.
4.
Dapoia la s-gioc giocuri soi di soi pit ațeal'i locuri di dor,
canda s-eascu ninga unoară ficiuric îmbitat tu dulț yisoñ,
s-mi legnu anarga ca tu sărămăniț sum aumbrăli di poñ,
ș-pântculu fântit cu fălili fripti s-îl'i u apun cu gioc încor!...

119. S'di pse?

1.
S'di pse në këtë ditë kaq të bukur me diell shkëlqimtar,
në të gjatin, të ashprin dimër të sivjetshëm dëborëplotë,
më është zhytur në mendime ky shpirti im ëndërrimtar,
duke më ri-sjellë në mendje bukuroshëzën rini gazplotë.
2.
S'di pse ditët e dikurshme më faniten përsëri madhështore,
sikur endesha mes shesheve e pyjeve hijerëndë të ahishtës,
tek kërkoja të dashurën fshehur nën gëmushat e lajthishtës,
bukuroshëzën si zanë si i dehur nga bukuri e saj engjëllore.
3.
S'di pse po dehin mendimet e mia nga imazhi e saj i bukur,
aq sa edhe sot më dërgon të më shoqërojnë urime të mbara,
edhe pse plak, më shkëlqejnë në ëndërrimet zjarr përflakura,
gjersa në gjinjtë e të bukurës si zanë jetën ta sos i lumtur.
4.
S'di pse tek po qëndroja i heshtur ndanë kroit ujë ftohtë,
m'u fanit një bukuroshëzë si zanë krejt e ngjashme me të,
i habitur e i gëzuar njëkohësisht ju afrova asaj dalëngadalë,
po papritmazi m'u fshi e m'u zhduk sysh si nëpër përrallë.
5.
S'di pse pastajza bukuroshëzën e kërkova ngado si i lojtur,
e cilindo që më dilte para e pyesja me merak me të lutur,
nëse ndofta vallë të bukurzën si zanë gjëkundi e kish parë,
po përgjigja ish "jo-ja" dëshpëruese e mbuluar me të qarë.

Tiranë, më 15.01.2005

119. Nu ştiu căţea

1.
Nu ştiu căţe aistă dzuă muşată cu luñinoasu soari,
tu lungoasa, aspăroasa şi neaumplinea iară di estinea,
tu munduiri ñ-easti hiptu suflitulu a ñeu di yisitor mari,
aducăndalui întru minti muşata tinăramea a mea.
2.
Nu ştiu căţe ñi s-scoală maroasi dzălili a meali năpoi,
ca când alăgam pi pădz muşaţ şi la fadzoasăli păduri,
iu s-căftam vrutea ascumtă pit lemñ strimţătoş di aluni,
muşatuşa ca dzănă, ca îmbitatu di noru a l'ei di anghioi.
3.
Nu ştiu căţe ma mi îmbeatu aisti amintirili ti imajulu a l'ei,
ţi ñi pitreţi urări îmbăr şi astădz cu dor s-mi asoţiesă,
tu a meali yisi ş-căţea auşatcu, luñinescu ca scăntei,
păn tu siñl'i ali muşata ca dzănă bana s-bitisescă.
4.
Nu ştiu căţe când ma steam ningă fleară cu apă araţi,
ñă s-fanăpsiună muşată ca dzănă întreaga ca năsă undzea,
diunoară chiundusit ş-hărisit mi aprucheai anarga la ea,
ma niaştiptat ñ-s-aştearsi, dit ocl'i ñ-fudzi ca tu părmithi.
5.
Nu ştiu căţea dapoia, ca giucat di minti muşata u căftai,
caiţido ţi ñ-inşea dinănti, îl'i u întărbam cu mari regeai,
nacă vahia muşatuşa ca dzănă avea vidzută iuva,
ma răspusiri a lor earea "nu", ţi mini multu mi dispărea.

Tirana, la 15.01.2005

120. Thashethemet

Sipas këngës popullore shqiptare:

"Ç'janë ato llafe, moj xhane, që dalin nga fshati,
të vërteta s'janë, moj xhane, se dalin nga inati!?..."

1.
Ç' janë ato thashethemnaja, që çuçuritin ngado përjashta në mëhallë,
të vërteta fare s'janë, sepse dalin e përhapen nga inati në befasim,
po syresh s'gënjehet askush, edhe pse të shkretat rrjedhin pa ndalim,
mbi shpirtrat tanë se janë zgjuar e të pa gënjyer asnjëherë me dhallë.
2.
Edhe këtu mes maelesh të lartë e hijerëndë në arumunin fshatin tonë,
si kudo nëpër botë ndër krojet ujëkulluar e ujëfreskët nën dëborë,
ku vashat mbushin bucelat e përhapin thashethemnaja pa drojë,
me fjalë nga më të pavërtetat këdo njohur e panjohur e përgojon,
3.
se mes atyre femrave ka nga ato që e vrasin së koti kohën e çmuar,
që tinëz si hije përgjojnë fjalët e pamenduara, andej-këtej lëshuar
nga njerëz të vegjël a të mëdhenj, të papjekur e pa qeder mëhallës,
pastaj edhe atë pak tru të mbetur ja nxirrnin jashtë kafkëgërdallës.
4.
Ndaj ne duhet të mendohemi mirë, para se t'i besojmë verbërisht,
te ne bredharakëve thashethemnajave e dala befasisht,
duke na zhytur në sherrnaja e që me fjalë të pista zihemi më pas,
që asnjë banor të mos mbetet në hasmëri me shokët e vet në fshat.
5.
Po sidoqoftë për këto thashethemnajat e përfolura nëpër kroje,
çdo njëri të mendohet për vërtetësinë e tyre me mendje kthjelltësi,
e para se t'i quajë të mirëqena, t'i përzgjedhë ato me gjakftohtësi,
përndryshe do t'i duken të hidhura si gjellë e servirura pa ngrohje.

120. Dzăsdățearnărli[1)]

După un cănticu popular arbineasu:

"Ți sunt aseali zboari, alăi giani, ți eas din hoară,
de alihea nu suntu, alăi giani, că ieas di inati!?..."

1.
Ți sunt ațeali dzăsdițearnări{20} ți șușurescu iuțido nafoară,
cu da alihea nu sunt eli, că s-dăsfacu di inati di niaștăptari,
ma nițiunu nu s-arrădi dot ș-căța șcretăli s-vomu fără dănăsari,
că pisti sufliț'i a noșț ți sunt minitimeñ și niarrădoș vărnoară.
2.
Ș-aua, namsa di munț aumbărgrei, di aistă hoară armânească,
ca iuțido tru duñeau pit flearăli cu apăli a l'ei areați curați
iu featițăli umplu buculil'i și dăsfac soi di soi di dzăsdițearnări,
ți cu zboari arădăroasi în gurli caițido acaț s-îl'i lăvășească,
3.
că namsa di eali sunt di ațeali femei ți frăngu chiroulu di încot,
ți ascumț ca aumbri ascultu zboari nimunduiti sălghiti însus-înghios,
di omñ ñiț a măr, dip nicopț, fără chideari pit ciucutirl'i tu măhălăi,
dapoia ș-ațea puțăna măduă armasă pri el'i îl'i u scutea cu arrădăi.
4.
Ti ațea noi lipseești s-ni munduim ți s-nu li pistipsim ahănt lișoarea,
dzăsdițearnărli, ți easă diniaștăpteari, ți alag gură di gură la noi,
și ni hig tru ancățari mări și ni luam cu zboari lăvoasi dinăpoi,
ta ma ș-nițiunu di bănătorl'i a noșț aspartu cu soț s-nu armănea.
5.
Ma cumțido s-hibă, aisti dzăsdițearnări urutoasi ți easu la fleari,
pri eli cafșunu la s-l'i ghixească cu minti cureat tru mădua a lui,
și nănti ți s-l'i l'ea cu de alihea la s-l'i dizleagă ghini cu săndzi arați,
că altăsoi ț-asparu amarri ca măcari aștrat pi sufri fără îngăldzeri.

6.
Prej këtyre thashethemnajash të këqija e të gënjeshtra sherr-ndjellëse,
që kushedi sa e sa herë në vogëli me shokë mi jam prishur dikur,
por edhe me të dashurzën time të shtrenjtë me bukuri rrëzëllejse,
prej zemërimit kam vuajtur në heshtje, sa mendsh mënd kam lojtur.
7.
Ç' janë ato thashethemnaja që çuçuritin ngado përjashta në mëhallë,
të vërteta fare s'janë, sepse dalin e përhapen nga inati në befasim,
po syresh s'gënjehet askush, edhe pse të shkretat rrjedhin pa ndalim,
mbi shpirtrat tanë se janë zgjuar e të pa gënjyer asnjëherë me dhallë.

121. Moj bukuroshezë e prindërve shqiptarë

1.
Vashës, bijë bukuroshe e prindërve të njohur shqiptarë,
që me imazhin tënd i kam përkundur ëndrrat e mia rinore,
në takimet nën qiellin e kthjellët plot me yje shkëlqimtarë
e në shpirt që gjer sot ende jeton mallndjellëse si lulebore
2.
dhe që atëherë, vashëzë e bukur, bukurosheza shqiptarkë,
janë rrokullisur vite që për së pari më ty rashë në dashuri,
ndërsa në shpirtin tim ende e mbaj të ndezur si zjarr në flakë,
në gaz jetën ta mbyll mbi krahët e tu të shtrenjtë me lumturi!
3.
Edhe pse arumunkat si zana më ndiqnin të dashuruara pas,
por zemrën time asnjëra syresh s'mundi t'ma rrëmbejë dot,
se ajo ditë-natë për vashëzën shqiptarkë digjej porsi zjarr,
çfarë s'bënë të dashurohesha me ndonjë nga to, po më kot.
4.
Ndaj më vinte keq për të bukurat arumunka zemërthyera,
që nëpër qoshe fshehurazi lotonin papushim të heshtura,
dëshpërimthellë e shpirtboshatisur prej trimit të munguar,
prej nga s'i shpëtoja dot se me shqiptarkën isha dashuruar.

6.
Dit lăvoasăli, urutoasăli dzăsdițărnări ți mi au țănut cu ngrăňă,
cai ști căt ori eu eascu asparsu tru tinăreaț a mea cu a ňei soț,
ma ș-cu scumpea vrutea a mea mușeat, mușeatușă ca dzănă,
dit anvrinera a l'ei am giucat di minti, mi ari lăsat tățitu fără boț.
7.
Ți sunt ațeali dzăsdițearnări ți șușureascu iuțido nafoară,
cu da alihea nu sunt eli, că s-dăsfacu di inati di niaștăptari,
ma nițiunu nu s-arrădi dot ș-căța șcretăli s-vomu fără dănăsari,
că pisti sufliț'i a noșț ți sunt minitimeň și niarrădoș vărnoară.

[1] *bărfă (româneşti)*

121. A lea muşatuşă di părinț arbineş

1.
A lea featiță, hil'ă mușatușă di părinț avdzăț arbineș,
ți cu imajulu a tău ňă l'i am lăngănat yisl'i tu tinăraț,
ptit cicutirăli sum țerulu cureat umplut cu steali luňinaț,
păn astădz eștă la suflitu ca îngăndoru lilici di neau arămăneș,
2.
și dit atumțea, ale featiță mușatușă arbinișuască,
sunt arucutiț mulț ani, ți ti protea oară pri tini băgai dor,
ți apreasu îl'i u țănu suflitulu a ňeu, ca vărnă foc s-pirărască,
tu harauă bana s-bitisescu la braț'i a tali scăldaț cu nor!
3.
Ș-căța armăncli ca dzăni după mi îngăna di dor,
ma inima a mea nițiunea di năsi nu putu să ň-arichea,
că ea noapti-dzuă tri fetița armbinușască ca foc arădea,
ți nu feță ta s-cădeam tu vreari cuună di eali ama di încot.
4.
Ti ața ňă vinea rrău ti armăncli mușati imnifrămti,
ți pi cohiuri ascumtă di nicăpăsieri lăcrimea tățită,
cu ahăndoea dispirati, cu sufliț'i gol'i di niaveari gioni,
di iu eu nu l'-ascăpam dot, că cu arbinișuși l'i-aveam alăxită.

5.
Që nga ajo kohë ngado pandaraz të shoqërova besnikërisht,
moj vashëzë bukuroshëzë shqiptarkë në të mira e në këqija,
dhe së toku rritëm bijtë të jetojnë me djersë ndershmërisht,
për të mos na turpëruar ne prindërit asnjëherë nga dembelia.
6.
Prandaj, moj vashë bukuroshëzë si zanë prindërish shqiptarë,
e lindur atje larg nën malin Gramoz në një fshat të njohur,
së bashku të mbijetojmë gjer në fund gjithmonë të lumtur,
si bashkëshortë besnikë të lidhur nga Perëndia për mbarë.
Tiranë, më 15.01.2005

122. E shtrenjta dashuri

1.
Ç'dreq qënkërka kjo e shkreta, e ëmbla sëmundje dashurie,
që, edhe i thyer, plak i mbetur me fare pak jetë për jetuar,
që më tërheq si me litar të gjatë prej çelniku me shumë fije,
gjersa të ndalem fare pranë të dashurës sykaltër i turpëruar,
2.
Ndërsa, vonë, i futur në shtrat, mendimet më nisen në shtegtim,
nëpër ëndrra bisedoja me të shtrenjtë të dashur sybukur,
që prej mallit përgjysmë ma ndan zemrën time të përflakur,
mësoj se me të vërtetë për dashurinë e parë vuan shpirti im.
3.
E, që i shtrirë, thura ëndrra shumë të bukura për të rishmëzi,
që sot banon larg prej këtej, sipër përmbi të bukurit luadhe,
duke pirë e u shpëlarë nëpër burimet ujëftohtë si sorkadhe,
sikur rendje anembanë për t'u zbukuruar porsi në rini përsëri.
4.
Përmbi sheshin gjelbërosh si një qilim gjigand pambarim,
ajo më përqafon për qafe me ëmbëlsinë e saj të pa matur,
sikur unë e mbartja në krah me të patreguarin mallin tim,
pastaj e shpie atje ku asnjë sy i keq s'ka për të më trembur.

5.
Di tru ațel chirou ti părmănai nidănăsitu vărnoară,
tu ghineț ș-tu arali ale fetiță mușatușă arbinișească,
și stog cărscum cilimeñ, ta s-băneadz cu sudor păn s-aușească,
tră noi părințl'i lucrutor s-nu ni arășunescă nițiunoară.
6.
Ti ațea, ale feată, mușatușă ca dzănă di părinți arbineș,
amintat aco diparti sum Gramoz, truună hoară cunuscută,
diadunu vă îl'i u bitisim bana a noastă totna cama vrută,
ca mul'eară ș-bărbat lăgaț tu pistimari di Dumnidză aleș.
Tirana, la 15.01.2005

122. Scumpea vreari

1.
Ți drac fusca aistă mărata, dulțoasea lăngoră di vreari,
ș-cățea eascu tricutu, aușeatcu arămas ninga nihiam ti bănari,
mi tradzi după năsă ca funi lungoasă di celnic săntosu,
păn s-chiundrescu ningă vruta cu ocl'i albastru arășinatu.
2.
Încăt, amnat, hiptu tu pat, ñ-s-închisescu muduirli tu arniu
și pit yisi zburăscu cu vruta a mea, ocl'imușaț,
ñi disparți inima apreasă di marulu dor pi giumtaț,
înveaț că de alihea ti prota vreari dori suflitu a ñeu.
3.
Și, di pi aștărrat, acățai s-l'i înpăltescu yisoñi mușaț ti ea,
ți astădz băneadz însus, aco dăparti pisti mușațăli livădz,
bearindalui și spealindalui tu apă arați la șopor ca sorcădz,
canda avrapai părț di părț a lor ti adreari mușaț ca atumțea.
4.
Pisti padea verdzoasă ca ghigandi sazmi fără sinori,
ea mi învărtești di gușă cu dulțema a l'ei nimisuraț,
canda mini îl'i u l'eau cu nispusulu doru a ñeu înbraț,
și dapoia îl'i u duc, iu nițiun ocl'iu arrău s-nu mi aspari.

5.
Shpejt vrapoj nën pemë që nga rrjedhin burimet ujëkulluar
dhe nën përkundjet të bukurës dashuri më zë gjumi i rëndë,
gjumi i rëndë më zë nga dashuria e bukur përkundjepëndë,
pastaj hedh vallen ngadalë shtruar me shpirtin të flakëruar.
6.
Nga kjo jetë, si ndonjë i dehur nga të bukurat ëndrra e mia,
gjersa të më vijë e dashura ime s'dua të ndahem asnjëherë,
të nisem për ta shoqëruar me gaz e dashuri gjer te shtëpia,
që të përplasemi në qoshen e dhomës sipërme si atëherë.
7.
Kur mëngjeseve të zgjohemi në nga gjumi i netëve të gjata,
m'u duk sikur isha futur në një botë tjetër fare të panjohur,
që ma gëzonte me mirësi zemrën në pleqëri, ashtu si dikur,
heshturazi them dua të ngjitem lart përsëri, edhe pse u mplaka.
8.
Po qëndroj më këmbë i frikësuar se zemra s'do të rrah më,
edhe pse shëndeti fare po më thyhet e për tokë po më flak,
po prej saj asgjë s'më ndan dot të mbetem në jetë fillikat,
gjersa në dejtë të regëtij pa më pushuar kurrë i pastri gjak.

123. Ç'janë ato zëra!?...

1.
Ç'janë ata zëra, aq të bukur e oshëtimëmbël, si vala mbi valë,
me bukuri përrallore na mahnitin me të zbardhur të ditës së re,
ndërsa dielli shkëlqimtar nxjerr kokën përmbi male e mbi re,
gjersa humbasin tok me tisin e natës që tendoset dalëngadalë.
2.
Shumë i mallëngjyer nga kënga melodioze e kalorësit guximtar,
duke vështruar kalërimin e tij mjeshtror mbi hamshorin pullali,
i befasuar nga kjo madhështi e pamjes së përtej kësaj faqe mali,
thërrita me gëzim: "Liria po na vjen bashkë me këtë lajmëtar!..."

5.
Cu troară avrapescu aco iu s-vomu șoporl'i, aco sum poñ,
ș-di pi ligănerea a mușatil'ei vreari mi l'ea somnu greu,
somnu greu mi l'ea di vrearea mușat cu ligănearea pi yisoñ,
dapoia gioc încor anarga, apreasu ca foc aistu suflitu a ñeu.
6.
Dit tru aistă viață, ca văr îmbitat di mușațl'i a ñei yisoñ,
nu voi s-mi disparț vărnoară putei, păn s-ñi yini vrutea,
s-mi închisescu și s-îl'i u asoțiedz păn acasa a mea,
ta s-ni păscănim la cohiu a udăului di ndzean fără omñ.
7.
Când tahina s-ni diștiptăm dit lugu somnu greu,
ñ-aspăru canda earam hiptu întregu tu duñau xeană,
ñi-îl'i u chărisea inima și ca atumțea, aușatcu a ñeu,
tu tățita dzăc ș-cățe chirut, ninga voi s-mi alinu ndzeană.
8.
Ma stău împrostu cu frixă că inima poati s-nu bati năpoi,
ș-cățea săntata ma ñ-s-frăndzi ș-mi arucuteești împădz,
ma dit ea țivea nu mi împarț dot ți eu s-armănu dinipoi,
până dit la a ñei siñ s-ñ-gioc fără căpăseari curatu săndz.

123. Ți sunt ațeali boați!?...

1.
Ți sunt ațeali boați dulțăoasi, ți arsunu ahănt mușaț,
nu s-teațeasc dicând s-sdăsfați naua dzuă di dimneaț,
încât soarăli luñinos scoati capulu pisti nor ș-munț analț,
păn chear stog chisea a întunicarilei, ți s-tindi neargaț.
2.
Multu emoționat di cănticu melodioz a gionilui pi calu călator,
mutrindalui călărerea a lui, încălcat pi cal hamșor,
chindusit dit aistă vidzută maroasă di cât fațea di munti,
strigai cu hărisimi :"Libertatea ma yini stog cu gionăli!"

Po trimi veç se kalëron me galop pa u ndalur nën bredhishte',
hedhur krahëve pushkën e zbukuruar me argjend mjeshtërisht,
shpirt-përflakur po vrapon si lajmëtar i lirisë shesh më shesh ,
për të mbjell ndër ne, rrjedha vallëzimesh nën ritme gëzimesh.
4.
Pastaj, në rrugëtimin e saj përqafohet me këdo që i del përpara,
takohet me tërë njerëzit, që e kanë pritur prej kohësh me dashuri,
e prej gëzimit, rrjedhur nga gjinjtë e tyre ndizen në flake e zjarr,
gjersa ngryset këndojnë e të hedhin valle pa pushim në lumturi.

124. Te kafeneja e mëhallës

1.
Që kur erdha këtu në Tiranë, në kryeqytetin tone dashur,
sapo nis të zbardh dita e re shkoj te kafeneja e mëhallës,
e, pasi i përshëndes "Mirëmëngjesi!..." të tërë sipas radhës
zë qoshen në një tavolinë të pandriçuar e qëndroj i heshtur.
2.
Edhe pse tani jam njohur, afruar e miqësuar fare mirë me ta,
kamerieri vjen shpejt e më pyet: "Ju lutem, ç'urdhëroni!..."
bufetierja e mençur ma dërgon ekspresin e ngrohtë si gjithnji, (për mirë)
e pastaj ngadalë nis të rrufis të ngrohtin lëng të kafesë së saj…
3.
Ndonjëherë kur i hedh sytë nga klientët e tjerë bëj sikur s'i shoh,
krejtësisht i heshtur e me qejf e rrufis lëngun e zi të kafesë përsëri,
e nga nxehtësi e saj shpirti i përmalluar më ngrohet përnjëherë,
pastaj s'dua të di nëse përjashta pa pushim si me gjyma bie shi.
4.
Më pastaj, pasi përfundoj së rrufituri kafenë e shijshme me qejf,
ndërsa ashtu siç jam i heshtur më vilen pambarim vargjet e bukur,
prej shpirtit si rruaza shumëngjyrëshe thurur me mall si në gjergjef,
duke i recituar heshturasi i përmalluar prapë zemër-zjarr si dikur.

3.
Ma gionilu calcălreași fără căpăsiri sum pădura di brădz,
cu tufechea lungă, adărat mușeaț di sărmu arucat în braț,
ti mușatea libertati, cu suflitu apresu, ampatră pădz di pădz,
ta să seamn la noi, vărsari di gioț umpluti cu hirdzeaț.
4.
Dapoia s-l'ea diguș cu caițido ți l'i easi în cali a l'ei,
s-adună cu oamñăl'i, ți îl'i u așteptă di când cu dor,
di hiri inșiti di siñăl'i, s-aprindu tuț ca foț cărmăgei,
până s-întunercă, el'i fără di căpăseari cânt și gioc încor…

124. La căfeneia dit măhălău

1.
Di când am vănit aua, Tirana, tru protulu a năostu căsăbău,
cât s-apreași luñina di naua dzuuă neg la căfeneia dit măhălău,
canda l'i-dauă urarea ca totna a bufetierlei: " Bunădimeața!"
mi duc la cohiu a l'ei și stău singurosu la tavola niluñineața.
2.
Ș-cățe tora ñ-eascu oaspițătu cu năș ș-ghini cănăscut,
camarierulu yini cutrăoară ș-întreabă: " Domnu, ți ursiți!?"
bufetierea mintimenă diunoară hearbi căfeia și ñi îl'i u pătreți,
și dapoia mini astragu cafeia a l'ei caldă, pi anarga îl'i u arufescu.
3.
Dicăt la clienț alanț arucu ocl'i canda nu l'i vedu cătvărnoară,
tățitoasu ș-cu chefi, u arucuteascu dzama lai ali cafei năpoi,
di calduroase a l'ei suflitulu a ñeu ñ-s-îngăldzești diunoară,
dapoia nu voi s-întreab ș-cățe nafoară da multu ploi.
4.
Cama dăpoia, când bitisescu cu chefi arucutirea ali cafei,
încât di cum eascu și tățioasu, ñi vomu nicăpăsiț stihurăndz,
inșiț anarga di la suflitulu a ñeu adrat mușaț ca mărdzei,
rețităndalui pri apus, ca atumțea năpoi ca la cuvăndz.

125. Ç'të bëj!?...

1.
Ç'të bëj se s'do ta kuptoj e dashura dashurinë time të pasosur,
i ngrati unë ku ta përplas kokën që ajo të më dashurojë rishtazi,
po me sa duket ndarja prej saj vetë Perëndia e ka paravendosur,
porsi gjethe e rrëzuar për tokë ta shtyj jetën pa dashuri vetmazi.
2.
Dhe papritmazi e kuptova se zemra më rreh fort ende nën gji,
ndërsa fortësinë e saj mund të më mbart nëpër malet hijerëndë,
ta hap edhe njëherë rrugëtimin nga do ta arrij me krahët e mi
e si zog të fluturoj përmbi pyjet e pashkelur kurrë me këmbë.
3.
Ç'të bëj se s'do ta kuptoj e dashura dashurinë time të pasosur,
i ngrati unë ku ta përplas kokën që ajo të më dashurojë rishtazi,
po me sa duket ndarja prej saj vetë Perëndia e ka paravendosur,
porsi gjethe e rrëzuar për tokë ta shtyj jetën pa dashuri vetmazi.
4.
Tok me barinjtë ndoqa tufat e dhenve tek shtegtonin në mera,
që ta harroj imazhin tënd që ndër ëndrra më është ende gjallë,
prej mendimesh të dëshpëruara ta shpëtoj këtë dashuri të rrallë
të endem tokës së ngrohtë, i rrahur ballit avujt të shtyrë nga era.
5.
Ç'të bëj se s'do ta kuptoj e dashura dashurinë time të pasosur,
i ngrati unë ku ta përplas kokën që ajo të më dashurojë rishtazi,
po me sa duket ndarja prej saj vetë Perëndia e ka paravendosur,
porsi gjethe e rrëzuar për tokë ta shtyj jetën pa dashuri vetmazi.

125. Ți s-fac!?...

1.
Ți s-fac că nu va s-mi aduchească vruta tri dorulu a ñeu,
măratulu di mini, iu s-mi păscănescu ta s-mi va năpoi ea,
ta s-mi dispărțăscu dit năsă ñ-ieasti scrisă di Dumnidzeu,
ca frăndz surpati împădz s-ñi pingu bana fără vrutea a mea.
2.
Di niaștăptarea acăchisii că inima ñ-bati ninga sum siñ,
încăt cu forța a l'ei poati s-mi port pisti analțl'i munț grei,
ta s-disfac și unoară cala piu s-îl'i u agiungu cu breațl'i a ñei
și ca pul'iu s-azboru pisti nicălcată păduri mari di chiñ.
3.
Ți s-fac că nu va s-mi aduchească vruta tri dorulu a ñeu,
măratulu di mini, iu s-mi păscănescu ta s-mi va năpoi ea,
ta s-mi dispărțăscu dit năsă ñ-easti scrisă di Dumnidzeu,
ca frăndz surpati împădz s-ñi pingu bana fără vrutea a mea
4.
Cu picurarl'i după a turmiloru mi închisescu s-îl'i îngănu tru arniu,
s-agărșăscă fănărusra a tău ți la yisoñl'i a ñia ñ-ieasti năpoi yiu,
s-scap dit mundirili a vrearl'ei, ți mi hidzi tru duñau dispăroasă
iu s-alag lișor străbătundalui la frămti a avrăl'iloru călduroasă.
5
Ți s-fac că nu va s-mi aduchească vruta tri dorulu a ñeu,
măratulu di mini, iu s-mi păscănescu ta s-mi va năpoi ea,
ta s-mi dispărțăscu dit năsă ñ-easti scrisă di Dumnidzeu,
ca frăndz surpati împădz s-ñi pingu bana fără vrutea a mea

126. Mes dhimbjesh të mëdha më poqi kjo jetë

1.
Që kur u futa në punë për të parën herë, shumë kohë ka kaluar,
këtë, qoftë edhe njëherë të vetme, ndërmend unë s'e kam çuar,
po se do të ndahesha prej saj ndonjëherë kështu me të vërtetë,
papritmazi e kuptova se po më afrohej shpejt pleqëri e shkretë.
2.
Pak nga pak po futem në ditët e mia të pleqërisë së rëndomtë,
që do t'i kaloj pa punë, pa të zgjuarit nxënësit e mi të dashur.
zbrastësia po më tërheq si zgjedhën ugareve buajt e mplakur,
po s'jepem lehtë, se mes dhimbjesh të mëdha më poqi kjo jetë.
3.
Edhe pse sot po ndahem prej jush, o nxënësit e mi të zgjuar,
kurrë s'ka për t'u shuar ky shpirti im i ndezur e i shenjtëruar,
ky i shenjtëruari e i ndezuri shpirti im s'ka për t'u shuar kurrë,
se më është stërrahur në varfëri të thellë atje ku ha pula gurrë.
4.
Pak nga pak po futem në ditët e mia të pleqërisë së rëndomtë,
që do t'i kaloj pa punë, pa të zgjuarit nxënësit e mi të dashur.
zbrazësia po më tërheq si zgjedhën ugareve buajt e mplakur,
po s'jepem lehtë, se mes dhimbjesh të mëdha më poqi kjo jetë.

126. Că bana mi cărscu pit mari dureari

1.
Cai ști cât chirou ari tărcut, di când eu inșii di prota pri lucru,
aistă ma ș-goală unoară nu ñ-am adusă tru minta a mea,
că mini vă s-mi dăspărțam di năsu vărnoară cu de alihea,
niaștăptat acăchisi că ma ñi s-apruchea aușaticulu greu.
2.
Nihiam cât nihiam ma ñi intăr tru nihiroasli laili dzăli a meali,
ți vă s-îl'i trec fără lucru, fără di vruțl'i buñ a mei elevil'i,
goleța ma mi astradzi ca boil'i vecl'i pit agril'i nali,
ma eu lishor a lui nu mi dauă, că bana mi cărscu pit mari dureari.
3.
Ș-cățe astădz ma mi împarțu dit voi mintimeñăl'i a ñei învățitor,
putei nu va s-ñi s-apuni aistu suflitulu a ñeu apresu yiurtusitor,
yiurtisirea și apreasu aistu a ñeu suflitulu nu va s-ñi s-apuni putei,
că ñă easti străbătut pit mări oarfañi ș-cu pădimădz multu grei.
4.
Nihiam cât nihiam ma ñă intăr tru nihirioasi laili dzăli a meali,
ți vă s-îl'i trec fără lucru, fără di vruțl'i buñ a mei elevil'i,
goleța ma mi astradzi ca boil'i vecl'i pit agril'i nali,
ma eu lișor a lui nu mi dauă, că bana mi cărscu pit mari dureari.

127. I dehur nga vargjet e mbara

1.
Që kur se erdha në këtë jetë të mirësisë e njëherazi të pështirësisë,
jam përkundur e ledhatuar me dashurinë nënës (atës) ëmbëlsisht.
që më mësoi si të dal e nisem në rrugët e pashkelura të vështirësisë,
për t'u endur viseve të botës andej nga të më çojë vetë zemralirisht.
2.
Që kur se kam ardhur në këtë jetë të mirësisë dhe kaq të dashur,
jam përkundur me aromën e ëmbëlth e dehëse të poezisë së bukur,
jo vetëm ndër pësime fatkeqësie a në dëshpërime të thella prej vetmie,
po edhe ndër gëzime pafund lumturie a gosti me dolli prej miqësie.
3.
Këto përjetime ma përshëndritën zjarr këtë shpirtin tim të plakur,
këmbët në mbarërrugëkalimin e duhur më drejtuan të shkel lirisht,
lirisht të shkel këmba më drejtuan në mbarërrrugëkalimin e duhur.
ndërsa vargjet e zjarrtë e të mallëngjyer seç më dehën tërësisht.
4.
Oh, edhe pse po më ndizet kaq i madh ky zjarr sot shpirtit tim
dhe s'po më lë të mendohem se për nga ta përhap këtë përmallim,
shpirt më shpirt arumun t'i dërgoj të rrjedhin në të mbarat rrugë,
gjersa mos jesë asnjëri syresh pa vallëzuar si i dehur gjer në muzgë!
5.
Pastajza, si dilni nga shpirti im të ngarkuar rëndë e bukristolisur,
rrokulliseni prej majëmalesh të mprehtë e hijerëndë gjer në të ngrysur,
përkundeni si në djepe mbi gjethet e aheve e të pishave halore,
si dhe çlodheni nëpër burimet ujëkristaltë e të ushqyera me ujëdëbore .
6.
Ende s'di se ç'do të bëj me këto uruarat vargje të bukurstolisura,
që veç rrjedhin pa pushim e gjithnjë më vështirë t'i mbaj të lidhura,
prandaj është më mire t'i lëshoj pa kapital nëpër rrugë krejt lirisht,
të bredhin shpirtnxehtë brez më brez të viseve arumune dashurisht.

127. Mbitat cu stihuri ambări

1.
Di când am vănit tru aistă bană di ghineaţ ş-di nivrutoasi,
ñ-eascu lăgănat cu dor şi dulţema di vrearea ali dadă,
ţi mi-nvăţă şi mi-chisea s-easu n-căl'uri nicălcati greuloasi,
s-alag pi visuri{21} ali lumi dicăt iu s-mi duc inima lişoară,
2.
Di când am vănit tru aistă bană di ghineaţ ş-di vrutoasă,
ñ-eascu lăgăneat cu ñurizma dulţi ali puezia muşaţoasă,
nu singur pi undzirili arăli ică dispirărăli ali singuroasă,
ma ş-pi hărisimi fără soni a părmănăiloru cuscroasă…
3.
Aisti străbănari ñ-arroşiră ca foc aistu auşatculu suflitu a ñeu,
eu la ambărtriţearăli di vruti mi condusăr ciciorăli s-calc lişor,
lişor ciciorăli s-calc mi condusăr cum s-vrea la ambărtriţearăli eu,
încăt ca bitu aisti stihuri pirăfocoasi mi îmbitară întregu cu dor.
4.
Ş-căţe ma ñă s-aprindi ahănt maru aistu foc tu suflitulu a ñeu,
ş-nu mi lasă s-mi mundueascu că pi iu doru s-îl'i u disfacă eu,
l-ambarăli căl'i s-l'i pătrecu suflit di suflit di armâñ s-vom ca şopor.
păn s-nu s-arămăn niţiunu di năş nigiucat ca îmbitaţ încor!...
5.
Dapoia când inşiţ dit suflitulu a ñeu, ngărcaţ cu muşteaţ,
vi arucutiţ dipi chipturăli suschitoasi dit aţeal' munţ multu analţ,
vi lăgăneaţ ca în sărămăniţ pit frăndz di fadz ş-chiñ muşeaţ,
incă vi dăscurmeaţ pit aţel' şopori cu api curaţ ş-areaţ-areaţ.
6.
Ninga nu ştiu ţi s-fac cu aisti uratăli stihuri adraţ muşaţ,
ţi cură nicăpăsiti şi să curri nu ma pot s-îl'i ţănu ligaţ,
ti aţea ma ghini s-l'i slighescu pi căl'uri lişoari fără căpestru,
s-alag călduroş casă di casă, băr di băr pit grail'u armânescu.

7.
Ndonjëherë kam dashur t'i lidh e t'i fus i mërzitur në thesin tim,
po sado u përpoqa s'munda t'i fusja brenda në të me të vërtetë dot,
si erërat në tërbim u zemëruan me mua tek desha t'i mblidhja tok,
tok t'i mblidhja tek desha me mua u zemëruan si erërat në tërbim.
8.
Si i lëshoj në liri nëpër të mbarat rrugë të pashkelura të kësaj toke
kapërcej mbi mjegullat e vështira, aq të përndarë në kohën e sotme,
nëpër fushat tona të shtruar bukurisht të ulen butësisht dalëngadalë,
ku të përflakur çmendurisht e bashkërisht të hedhin valle valë-valë.
9.
Edhe ashtu siç jam i shtrirë, si i dehur me to nis të bisedoj me mall: "
Vallë, për nga do të kaloni, ku do të përplaseni përsëri ju lirisht!?
Do lëshoni futur thellë në tokë rrënjët e atdhetarisë sonë trimërisht,
do të nxirrni e rrisni mijëra fidanë të bukur tokat tona me strall!"
10.
Pastaj, i ngrati unë, u përgjigjem me gëzim të madh përnjëherë:
"Sido që të jenë shkruar, sido që të bëhet me poezinë time mëpastaj,
me të vërtetë shpresoj se ca nga ato mund të kenë mbetur me vlerë,
në shpirtrat e arumunëve janë mbjellë të mos harrohen paskëtaj!..."

7.
Cătăvroară vrui s-l'i legu și s-l'i higu di dăspăreata la sac a ñeu,
cumțido ți mi părpălii nu putui cu dalichinea s-li hidzeam dot eu,
ca vintu turbat s-învăreară când vrui cu mini s-l'i adunu diadun,
diadun s-l'i adunu când vrui cu mini s-învăreară ca turbatu vintu.
8.
Canda îl'i slighiescu lișoari pi îmbărili căl'uri nicălcati pi aist loc,
ansară pisti negurăli greali di aisti chiroi di astădz ahănt disfapț,
s-apunu anarga-anarga pisti pădz aștraț mușaț-mușaț,
iu ca ciurtiti ș-apraș ca foc imni diadun s-acaț și s-gioc încor.
9.
Di cum eascu teasu, ca îmbitat di eali, acaț s-mi zburăscu lișor:
"Vahiă, piu vă trițaț, piu vă s-vi păscăniț lișor năpoi voi!?
Vă s-li lăsaț hipti în tărroc rădzițiñăl'i, umpluti cu di patria dor,
vă s-scuteț și s-îl'i crișteț caiști cât fidăñ mușaț ti tuț noi!"
10.
Dapoia, măratulu di mini, mi răspundu cu harau diunăoară:
"Cumțido s-hibă scrisi, cumțido si-s-facă cu poezili cama dinăpoi,
sper cu de alihinea ți niscănti di eali poati au arămasă năpoi,
tu sufliţl'i di armâñ sunt sămnaț ta s-nu agărșeascu văroară!"

128. Dasmë shqiptare

1.
S'di sepse sot m'u fanit në mendjen time si ylli në qiell i përflakur,
o më i madhi poet Konstantin Belemaçe në tërë viset arumune,
i ftuar me dëshirë e gaz në këtë mbrëmje të veçantë e aheng të bukur,
nga kushërira e gruas në dasmën e birit të vetëm ritur me derte.
2.
Ata vargje të bukur të baladës tënde të rrallë "Dasma shqiptare",
kur para shumë kohe më i madhi ndër shqiptar Shahin Matraku,
martoi më të madhin bir të shtrenjtë, me gaz e lumturi prindërore,
me bijëzën e beut të njohur Murat, Bebeana e mençur e sybukur.
3.
Ai i ftoi arumunët vëllezër më gjak Kokonesh, tok me trimat e vet,
Tuna e Jana Kokoneshin në tërë trimat arumun më i zgjedhur,
dhe i nisi si besnikë në krye krushqve për të marrë nga larg të renë,
t'ja sillnin të bukurën si zanë, bukuroshëzën nuse të djalit belkëputur.
4.
Rrugëkalimi për të shkuar në shtëpinë e krushkut me nam Murat,
gjarpëronte e gjatë përmes pyjesh hijerëndë e të pashkelur asnjëherë,
po krushqit s'i ndalte asgjë, veç rrugëtonin me gaz nëpër monopat,
duke kënduar e vallëzuar tek pushonin ndanë burimesh ndonjëherë.
5.
Po shqiptarët e arumunët e soţhëm dasmat përsëri i ndezin tek ne.
por jo me nusen e mbuluar me vello të bardhë e krushq në kuaj hipur,
ndërsa kanë mbetur po aq të ndezura gëzimerënda e dollitë me funde,
ashtu edhe vallet e këngët e zjarrta trimërore ziejnë përsëri si dikur.
6.
Ndaj i përfytyroj gunëhedhur gjer në tokë e të zbukuruara aq bukur,
shqiptarë e arumunë, seç këndojnë e hedhin vallet shtruar e ngadalë,
në të bukurat ato derdhen paprerë në lumin tejmbushur e tërë valë,
sa herë mblidhen të kremtojnë tok me hare dasmat e bijve të lumtur,

128. Numtă arbinuşască

1.
Nu ştiu căţea astădz ñ-ti aprideş tru minti a mea ca vărnu steau,
a lăi maru poet Costantin Belrmace, di tut grailu armânescu,
tru aistă seară muşat ţi la numtă eascu ancl'imat ca oaspiţu,
la însurara al hil'iusu di prota cusurină ali mul'earmea a meau.
2.
Stihuri ahănti muşaţ a baladiei a ta "Numtă arbinuşească"
ţi multu chirou nănti feaţi ma marulu arbines Şahin Matracu,
când însură scumpulu hil'u-su a lui cama mar cu harau părintească,
cu hil'ăsa a beului cănăscut Murat, muşeata Bebeana ca zmeu.
3.
El l'-încl'imă armâñăl'i fraţ cu săndz stog cu a lui gioñ arbineş,
Tuna cu Iana Kukuneş la tuţ armâñ gioñi cu nami cama aleş,
şi îl'i închisi cu pisti ca protl'i a cuscuriloru ta s-l'ea înveasta a hil'isu,
s-îl'i aduţea muşata ca dzănă, muşatuuşa nveasta a lui ficioru.
4.
Caltriţeara ţi ti aduţea la casa a cuscrului cu nami Murat,
şarpăşea multu, lungă pi păduri aumbrigreali putei nicălcat,
ma cuscrăl'i nu îl'i ţinea ţivea, singur călărea cu harau pit monopat,
anda cănta şi giuca fără căpăsearii ningă şopori sum dzad.
5.
Arbăneşl'i ş-armâñăl' di astădz numtăli îl'i aprindu cu goi la noi,
ma nu cu înveastăli amvăliti cu vezonu alb ş-cuscril'i încălcaţ pi căl'i,
încăt au arămasă nica ahănt apreasi cu brindisiri cu soni năpoi,
aşiţ cu încoruri, cănţuri focuoasi hierbu ca atumţea ca văl'i.
6.
Ti aţea aşiţ îl'i yisescu cu tămbărli păn di padi, adăreaţ cu muşeaţ,
arbineş ş-armâñ ca fraţ cănt ş-gioc încor anarga şi aştirraţ,
pit muşatăli di eli s-vearsă fără căpăsiri pi arrăuri apăumflati cu dor,
căt ori el'i sărbătorescă diadun cu hări însurarăli a hil'iloru a lor.

129. Viti i mbrapshtë

1.
Ky vit i mbrapshtë mos na ardhtë më asnjëherë,
sepse shteti u shthur, humbi i tëri pa lënë gjurmë,
nga të gjitha anët e qytetit zbrazeshin zjarr armë,
se kush ish shkurtuar merrej vesh në mëngjes herët!
2.
Nga na erdhi kjo fatkeqësi e nëmur si sheshbeteje e pështirë,
arumunëve e vëllezërve shqiptarë, cili jua solli këtë gjëmë,
e parathënë prej Perëndisë mos e shohim kurrë sytë tënë,
qoftë edhe një ditë të vetëme me pamje mëkatare në gdhirë.
3.
Ditë aq të mallkuara si këto të luajnë mendsh,
të kthejnë prapa në kohëra të urryera të humnerës,
ku s' gjenden dot rrugët për dalë prej skëterrës,
e ku gjithçka është shthurur e hedhur në shesh.
4.
Prandaj le të mos na vijnë kurrë më ndonjëherë,
si ky vit i padëshiruar, i urryer, i ashpër e i mallkuar,
sepse ne arumunët me vëllezërit shqiptarë për gjithherë,
duam të rrojmë në paqe e përjetësisht të lumturuar!...

129. Anu anapudha

1.
Aistu anu anapudha puteiă la s-nu yină vrăoară,
că statulu s-asparsi, chiru întregu fără urmi,
dipi tuti părl'i la căsăbăulu cărținea foc di armili,
singur dimneața s-îl'i u avdza că cai s-şcurtă.
2.
Di iu nă vini aistă nipistăpsită zulumi ca di alumtil'ei,
a armâñiloru și a arbineșiloru, cai îl'i u adusi aistă urghie,
ți í năintidzăsă di la Dumnidzeu s-nu videm ma putei,
ma ș-goală singurună dzuuă cu mutrită ca di cărmie.
3.
Dzăli ahănt blăstimati ca aisti ti gioc di minti,
ti șuț dinăpoi, tru chiroi urruti ca ali humneari,
iu nu s-află căl'urili ti inșiri dit ațea piscuteari,
iu ți̧do esti dispul'iat și arucat împădz ca lăvășiti.
4.
Ti ațea s-nu ni yină aua puteiă vrănoară di nău,
ca aistu anu ahănt nivrutu, urrut, aspru, blăstămatu,
că noi armâñl'i și vruțl'i freaț anoșț arbineș,
vrem s-bănăm cu păce ș-hărisim ca gioñ aleș!...

130
. Motive të
Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare

1.
Tek çdo banor i fshatit tonë një thashethemnajë ish përhapur,
se Brigada e Parë ishte nisur të vinte ende pa u ngrysur,
në tërë Shqipërinë nami e heroizmi i saj njihej nga kushdo ,
gjithkush komandantin e saj Mehmet kërkon ta takoj sot.
2.
Të rreshtuar në formacion marshimi tërë forcë e shpirt përflakur,
ky ideal e madh i atdhedashurisë në hapin i tyre s'kish të ndalur,
të ndalur s'kish në hapin i tyre ky i atdhedashurisë ideal i madh,
për ty e shtrenjta Shqipëri e derdhim gjakun si lumë valëmadh.
3.
Tërë grabovarët, të vegjël e të mëdhenj, shpejtë shkuan te dyqanet,
partizanët e rreshtuar i vështronin të çuditur shumë të përmalluar,
ndërsa çdo kryefamil'ar marr dy-tre prej tyre, nga këshilli të caktuar,
në çdo shtëpi, ndër të rinj zgjuan dëshirën për të shkuar partizanë.
4.
Si u çlodhën, u lanë e u shpëlanë mirë e bukur dy-tre ditë te ne,
me të dëgjuar kushtrimin u mblodhën e u niseshin në misionin e ri,
ndërsa zemrat u ndezën për partizanët që nisen në luftën çlirimtare,
duke mbjellë ngado gëzim e hare, se e bardhaliri do të vijë përsëri.
5.
Që nga oborret vështronim me mall, tek humbisnin tej pas malesh,
rreshtat e trimave në marrshim duke kënduar për të shtrenjtën liri,
krenar se pas i ndoqën përmbi pesëmbëdhjetë djem trima me nam,
që bijtë u nisën të çlironin atdhenë secili prind u gëzua me krenari…

130. Motivi a
Aluptil'ei Antifaştă Național-liberatată

1.
La bănătorl' a hoaril'ei s-dăsfeațiună dzăsdițearneari,
că Prota Brigadă s-închisi s-vinea ninga ali întunicari,
tru întragă Arbinișia ghini di tuț anamea îl'i s-cunuștea,
caițido di el'i cu comandatu Mehmet astădz vrea s-ciucutea.
2.
Tu aradha la formacionu di marșu cu forță ș-sufliț'apiroașț,
cu patriavrearu idealu mari imnarea a lor n-avea cai s-chiundreașț,
chiundreari n-avea a lor mrașu, cu a patriavreariei ideal mari,
tră scumpa Arbiniși vă îl'i u vărsăm săndzăli ca arrăuri apiturbati.
3.
Tuț grăvăñoțl'i, cu ñiț cu măr, s-dusără cutroară la dugeñă,
partizăñăl'i tu aradhali mutrea multu chindusiț cu maru dor,
dapoia cafișun di proțl'i a căsiloru l'ea căt doi-trei ca ospiț,
casă di casă pit tinărl'i s-apresi vrearea tă inșiri partizăñ.
4.
Când el'i s-dăscurmară și să spălară ghini dau-trei dzăli la noi,
căt avdzără alarmu s-adunară, s-închisiră tru misionulu nău,
imnili s-apreasăr ti partizañl'i ți tu alumtă nidzea cu hărău,
sămnăndalui hărisimi mari că libertatea vă s-ni yină năpoi!
5.
Di la uborl'i a noșț îl'i mutream cu dor, încăt ma chirea după dzeñ,
aradhili a gioñiloru ți imna căntăndalui ti duruta libertati,
măndăr că după el'i si dusăr pisti țispărdzați di ficior ca azgăñ,
nițiun di părinți nu s-dispără că hil'i s-închisiră ti libertatea ali patri.

131. Prindërit e mi

1.
Tek varri juaj i zbukuruar me mermer të bardhë kam ardhur sot,
ju kam sjellë një tufë me karafila të kuq prej nga banoj me dashuri,
e, pasi i ujdis me kujdes, i lëshoj me ngadalë mbi të me dhembshuri,
ndërsa përmbi faqe më rrjedhin pa pushim rrëke të ngrohta me lot.
2.
Këtu nën plloçat e ftohta e të heshtura, të bardhësisë së mermertë,
ku preheni ju prindër të shtrenjtë në gjumin tuaj të thellë e pa kthim,
të ndjellë nga avuj e vdekjes së mbyllur në terrin e gjatë në trishtim,
tok jeni takuar përsëri për të mos u ndarë kurrë prej natës skëterrë.
3.
Së pari po bisedoj me ty Stavri, i shtrenjti e i paharruari ati im,
se imazhi e shpirti yt mbijeton brenda meje i pa humbur përjetësisht,
porosi të ndritura për të udhëtuar nëpër terr nën yjet me shkëlqim,
krenar e ballëlartë se gjaku yt rrjedh nëpër dejtë mijë kthjelltësisht.
4.
Po edhe ti moj nënë Klane, grua e forte dhe ndershme arumune,
që kur jeni bashkuar në jetën e gjatë e të amshuar në parajsë përsëri,
i heshtur me mall u përcjell përshëndetjet e nipërve tuaj lindur nga ne,
ndërsa s'më shoqërojnë më si dikur porositë prindërore plot mençuri.
5.
Tek vari juaj i zbukuruar me mermer të bardhë kam ardhur sot,
ju kam sjellë një tufë me karafila të kuq prej nga banoj me dashuri,
e, pasi i ujdis me kujdes i lëshoj me ngadalë mbi të me dhembshuri,
ndërsa përmbi faqe më rrjedhin pa pushim rrjedha të ngrohta me lot.

131. Părințl'i a mei

1.
La mărmintul a vostru, adărat cu mermer alb am vănit astădz,
di iu bănedz v-am purtatună tumbă di cărăfili aroș mușaț,
canda îl'i îndreag pri anarga, îl'i silghescu pisti el cu dor,
încăt pisti faț ňă s-vearsă nidănăsiti rricel'i di lăcri călduroș!...
2.
Aua sum aisti plăț arațoasi și tățitioasi a mărmărlui alimaț,
iu di când cădzut în somnu fără turnari voi scunchi părinț a mei,
îngănaț di duhlu morțoș, încliș tu lungă chisă întunicarilei,
diadunu hiț adunaț ninga unoară ta putei s-nu vi dispărțaț.
3.
Nănti voi s-zbureascu cu tini, a lăi Stavri niagărșitu tată a ňeu,
făhărusira și suflitlu a tău la mini vă s-străbăneadz nichirut putei,
dimindăi luňinoasi ti imnari pit chisăli căl'iuri ca luciňăl'i di zmeu,
mândăr împrostu că săndzăli a tău ňă curră curat din siňi a mei.
4.
Ma ș-tini, ale nănă Klantă, mul'eară tiňisită armânească,
di când hiț aduneaț tru ațea lungoasă bani di în paradisu năpoi,
tățitoasu vi pătrecu cu dor încl'iciuň dit nipoții amantetați di noi,
ti ațea lăcărmascu că nu am avăoastri dimăndăi ți s-părmănască.
5.
La mărmintul a vostru, adărat cu mărmăr alb am vănit astădz,
di iu bănedz v-am purtatună tumbă di cărăfili aroș mușaț,
canda îl'i îndreag pri anarga, îl'i sălghescu pisti el cu dor,
încăt pisti faț ňă s-vearsă nidănăsiti rricel'i di lăcri călduroș!...

132. O trim, prej cilit e pse trembesh ti?

1.
Edhe pse i mbetur fare bosh, i zhytur në dëshpërim:
pa shok, pa miq, pa të dashur dhe pa të dashura,
por ai s'jepet, s'zvarritet porsi krimbi nëpër tokë,
po ecën pa u ndalur natë-ditë së toku me kohën.
2.
S'dihet nga do ta shpien këmbët për ta turpëruar,
ai edhe pse s'do, do të shkojë për atje plot me dëshirë,
ai ngado t'i hedhë hapat prapëseprapë del më i fituar,
e do të mbijetojë sesa nga tërë të tjerët edhe më mirë.
3.
Pastaj shpëlahet me gëzim të madh në të ftohtat burime,
që rrjedhin paprerë me kthjelltësi gjersa arrijnë këtu te ne,
prej maleve tonë të lartë majë borë veshur e qeleshebardhë,
nga ta mbart i me mall në krahë të dashurën bukurizanë.
4.
Për ç'hallë dhe prej cilit trembesh ti or trim namëmadh,
or namëmadhi trim prej cilit ti trembesh dhe për ç'hallë,
ndërsa tani vrapon si lojtur e i frikësuar luadh më luadh:
nga cili e pse jeta jote të është svjertitur kaq shumë vallë!?...

Tiranë, më 18.12.2004

132. A lăi gione, di ți ş-di cai tini ti aspari!?

1.
Ş-căţe easti hiptu tu dispărareaţ armasu goalu:
fără di soţ, fără di oaspiţă, fără di vruţ şi vruti,
ma elu nu s-da, nu s-ruchiuşeaşăti ca yermu împadi,
ma imnă nistătut noapti-dzuuă diadunu cu chiroulu.
2.
Nu s-şti dicăt iu va s-îl'i u duc ti arşunari cicioarăli,
elu ş-căţea nu va, va ți s-neargă cu harauă dicat aco,
elu easi năpoi cama amintatu di tuţ piuţido ți s-gioc,
vă s-străbăneadz di alanţ cama multu căt cama ghini.
3.
Dapoia s-ascaldă cu mari hărisimi pit şopori apă-araţi
ți curră nicăpăsiti curaţ-curaţ până agiungu aua la noi,
di pi munţ analţ cu neauă învăscuti chipturi ca căciuli albi,
iu s-îl'i u port îmbraţ vruta ca dzănă, ți mi îngăni dinăpoi.
4.
Di ți ş-di cai ti aspari tini a lăi gione cu anami mari,
tini a lăi gione cu anami mari di ți ş-di cai tini ti aspari,
încăt avrapeşt ca giucatu pădz di pădz pi ciciorl'i fricuşitu:
di cai ş-căţe aţăia ți easti lăvăşit ahănt banea a tau!?...

Tirana, la 18.12.2004

133. I pavendosuri
- filozofike -

1.
Të afërmit, miqtë, të njohurit e shokët e mi të dashur,
më luteshin:"Ndahu nga pandehmat e tua pa vërtetim,
për këdo në kohët moderne e reja erdhi mjaftë e bukur,
na kërkon t'i shndërrojmë vjetërsirat në mbarsi e gëzim!"
2.
Prandaj në vetmi e rëndoj kujtesën me lloj-lloj mendime,
mbremjeve ende pa më zënë gjumi bisedoj me veten time,
pasi i bluaj e peshoj mirë thellësive të ndërgjegjes sime,
menjëherë nis të loz rolin të pavendosurit me pështjellime.
3.
Pastaj, i ngrati, s'di nga të shkoj e nëpër ç'rrugëkalim,
s'di të zgjedh se nga është më mirë e më e mbarë,
më e mbarë e më mire se nga është të zgjedh s'di,
ndaj shokët më thërrisnin " pandehmaxhi" më të rrallë.
4.
Ndonjëherë në heshtje them: "Gjithë çelësi i jetës time,
zbulohet më qartësisht me argumentime materialiste,
sesa kur ua shpjegoj stilemat me metodën metafizike,
nxënësit s'mbeten të qartë e të bindur prej fjalës sime.
5.
Por në mësimdhënie më mirë të eci sipas përvojës time
se nxënësve stilemat ua zgjidh me estetikën materialiste,
ndërsa në tekst i mësojnë sipas të pakuptueshmes idealiste,
i them vetes: "Pse, s'mund të loz dot prej rrugës sime!?"

133. Niapufusitorlu
- filozofică –

1.
Apropiațl'i, oaspițl'i, cănăscuțil'i ș-vruțil'i a mei soț,
ñi să pălăcăresescu:"Mut măni dit crederili a tali,
că ti caițido tru chiroulu modern nou intră cu nor,
cafti s-îl'i alăxim vecl'ăli cu ambărli ți yinu ca vali!"
2.
Ti ațea ñi vatmu mintea cu munduiri pri singuroasea,
când serăli di nimiacțat somnulu zburescu pri a mea,
canda l'i mațnu ș-înghixescu di la ahănda ali conștienț
diunoară acaț s-gioc rolulu di niapfasitorlu cu l'ieț.
3.
Dapoia, măratulu, nu știu că pit ți cali s-imnu,
nu pot s-îl'i u aleg di cai parti să l'eau cala m-ambari,
m-ambari cala s-l'eau di cai parti s-îl'i u alegu nu potu,
tri ațea soțl'i mi încl'ima "creditoriosu", cu arădeari.
4.
Vărnoară tățitu dzăc: "Tută căl'iuri a viației a mea,
s-dizvăleești ma curat după argumenti materialistă,
di cât interpretarea al stilemăli cu metoda metafizică,
ti ațea elevilor nu ñ-arămănu crezut di de alihea.
5.
S-imnu cu experiența di dascalu ñ-aspari ma ghini,
că elevilor stilemăli îl'i u înveț cu estetica materialistă,
încât la texturi îl'i înveaț după ațea niaduchita idealistă,
și pri a mea dzăcu: "Cățea nu poti s-mi giocă dit a mea cali !?..."

134. Për dashurinë tonë të fshehur

1.
Kam shumë kohë që s'jam takuar me të dashurën time të shtrenjtë
dhe, oh, sa shumë më ka marrë malli për ata sytë e saj aq të bukur,
prandaj për të vajtur në vendbanimin e sotshëm vrapoj me të shpejtë,
edhe njëherë të takohem me të duke më dehur me të puthura si dikur.
2.
Po kur të arrij s'di sesi do të shtirem ndaj tërë të afërmve të saj,
që për dashurinë tonë të fshehur prej shumë kohe s'kanë fare dijeni,
po cili do më mbajë të mos shkoj për ta qetësuar shpirtin tim paskëtaj,
të vrapoj me këmbët e mia për tek ajo i pa frikësuar rishtazi si në rini.
3.
Sapo arrij përpara portës së atij oborri të shtëpisë së saj aq të bukur,
kuptoj që se zemra ime ende më rreh fort paprerë nën gjoksin tim,
i ndërgjegjshëm në mirësinë e në bukurinë e syve të tu të shndritur,
të ma shuaj këtë shpirtin të përflakur prej kësaj dashurie pambarim.
4.
Që prej shumë kohësh s'e pandehja se do ta shëtisja bahçeve përsëri,
mes lloj-lloj lulesh aromëmbla në rrugëtimin e saj dalëngadalazi,
dhe të bridhja duke e mbartur në krahët e mi anembanë pa pushim,
gjer të ngopshim pa prerë me të ëmbla puthje tona në vëlim,
5.
Po tani që të dashurën time të shtrenjtë, i ngrati, e takova sërish,
cili do të ma qetësojë zemrën të mos më pëlcasë nga ky përmallim,
se erdhi çasti i urryer për t'u ndarë nga shoqërimi i saj pa mbarim,
e nga mosdashja e ndarjes jemi zhytur në dëshpërim bashkërisht.

Tiranë, më 20.02.2006

134. Ti vrerea a noastă ascumtăoasă

1.
Am di când ți nu eascu ciucutit ma cu scumpea vruta a mea
și, oh, cât mi ari loat doru ti ațeal'i ahănt mușeațl'i ocl'iăl'i a l'ei,
ti ațea cutroară s-negu dicăt aco iu băneadz ninga ea,
s-mi adunu ninga unoară cu năsă îmbităndalui di bașiei
2.
Ma când eu s-agiungu cum s-mi tragu nănti di apropiațl'i a l'ei,
ți nu știu ținea ti vrerea a noastă ascumtăoasă di multu chirou,
ma cai poti s-mi țăni, s-nu nergu la ea ta s-îl'i u taț suflitlu a ñeu,
nifricușitu ca tru tinărami cărțănescu aco iu í ea cu ciciorl'i a ñei.
3.
Căt agiungu nănti la porta dit uborului mușaț a casil'ei a l'ei,
aduchescu că inima a mea ñ-bătănești fără căpăsiri sum cheptu,
coșientu tu ghinețea ș-tu mușuteața sălghit di aței ocl'i scăntei,
poati s-ñi apună piriasului suflitu a ñeu dit vrearea fără sonu.
4.
și di chirou nu pistipseam că vă s-îl'i u priimnam năpoi pit băhcei
ta s-îl'i u disfățeam pit soi di soi lilici, cu añorizmi dulți cala a l'ei,
s-alăgam părț di parț purtăndalui a năsl'ei în breațl'i a mei,
până s-l'i fănteam suflițl'i cu nidănăsatli nostămăli a noastri bașei.
5.
Ma mărătulu di eu tora ți cu scumpa vruta a mea mi adunai,
cai poati s-ñi tățească inima s-nu ñ-creapă di bătănari di dor,
că vini chiroulu urutu ți s-mi împarț di a l'ei lundzăli asotsiari,
di nivrearea a împărțăril'ei him hipț tu mări dispărări doil'i noi.

Tirana, la 20.02.2006

135. Të ikurit e gënjyer rishtazi

1.
Gjer më nëntëdhjetën Shqipëria nga çdo anë ish krejt e izoluar,
por nga kjo shtrëngesë u ngrit e u ngulit thellë një psikologji e re,
jo vetëm tek të më të rinjtë, por edhe tek më të moshuarit ndër ne,
që nëpër shumë shtete të huaja të botës të shpërndahen pa pushuar.
2.
Atje ku shkuan ata u futën për të punuar në punëra më të rënda,
për një krodhe buke të thatë tek afendikoit i gjunjëzoi e pangrëna,
pastaj për të shuar urinë brejtëse të stomakut të tyre të boshatisur
pastaj t'u dërgonin para familjarëve të tyre prapë për t'i ringritur.
3.
Mikpritësit e huaj i pritën sikur gjoja ishin të keqardhur për ta,
po më pas i futën të kryenin punët e lëna prej tyre mjaftë të rënda,
pa pyetur se ishin arumunë a shqiptarë, të ikurit e gënjyer rishtazi,
që endeshin shtëpi më shtëpi nëpër huajdhesi 1) të uritur e heshturazi,
4.
Edhe pse janë shumë larg prej atdheut, atje në huajdhesinë e urryer,
gjithë të ikurit punojnë gjatë tërë ditës gjer në të ngrysur pa pushim,
ndërsa mbrëmjeve prej lodhjes i rrëmben gjumi i ëmbël pa shqetësim,
duke ëndërruar ditën e lumtur e të bukur kur sërish do jenë kthyer,
1) huajdhesi - dhe i huaj

135. Fudziți'i arăş di nău

1.
Păn la naudzăl'ia Arbininişia fu înclisă dit tutăli părț,
ma dit aistă strimțătoasă s-îngărfăsiună psicologhi nau,
nu singur pit la tinărați'i a noșț, ma ș-pit la ma aușăț,
ta s-fug fără căpăseari pit multi stături xeani ali duñeau.
2.
Aco iu s-dusără el'i întreară s-lucra pit lucril'i cama greali,
la afendicoil'i el'i s-zănucl'iară tiună măşcătură di păni goală,
nănti ta s-aplecă foamea di nimăcarea ți îl'i u îngărca cu areali,
dapoia s-pătrec păradz în căsurli ta s'pot averea năpoi s-îl'i u scoală.
3.
Oaspitățl'i xeañ l'i aştiptară canda ti năş îl'i u vinea arău,
ma dapoia îl'i băgară s-fițea ma greili lucruli lăsati di el'i,
nintribat că sunt armâñ ică arbineş fudziți'i arăş di nău,
ți pit xeanitati alăga casă di casă foamitoş, tățiț ș-fromñi ca ñel'i.
4.
Ș-cățe sunt multu diparti, aco tru xenitati urrută, dit patria a lor,
tuț fudziți'i lucreadz tut dzua nidănăsiț păn pri întunicari,
când seară di seară acurmaț îl'i arăcheaşti somnulu cu yisoñ,
yisăndalui ti ațea muşeata dzuuă ali cama apropea şuțeari.

136. Nga më erdhi kjo e madhe mbarësi

1.
O ju shokë të besës më rrëfeni nga më erdhi kjo e madhe mbarësi,
që të shpëlahem edhe njëherë nëpër burimet e kthjelltë nën ahishtë,
ku zogjtë krahëshkruar dhe zëëmbël cicërojnë pa pushuar ëmbëlsisht,
ndërsa meloditë, si i dehur më fusin në gjumë mbretëror ngadalësisht.
2.
O shokë të jetës e të besës si vëllezër më shpëtoni nga kjo dashuri,
duke më shpënë edhe njëherë në Sheshin e Bukur të Ftujakëve,
ku duke lodruar e kënduar pa pushuar gjersa të gdhijë dita përsëri,
ta harrojmë dhembjen që na sjell gjithnjë ai të përflakur prej malleve.
3.
Siç rrëfejnë të moshuarit e bukura e dheut del herët në mëngjes,
të lahet ngadalë e hareshëm, atje në Liqenin e Zi, përmbi ahishtë,
e fshihet pranë pyllit të pashkelur, gjersa dielli perëndon pasdrekes,
duke pritur të rindal qielli pa re, nën ndriçimin e hënës bukurisht.
4.
I shtyrë prej legjendave të bukurëzën e dheut e kërkova pafund,
edhe pse e lashë zemrën të kërkojër bukuroshëzën time lirisht,
e gjersa u poqa brodha, po bukurinë e shpirtit s'e gjeta askund,
ndërsa iu qepa pas, më mirë është të më gjejë ajo, u binda plotësisht.
5.
O ju shokë të besës më rrëfeni nga më erdhi kjo e madhe mbarësi,
që të shpëlahem edhe njëherë nëpër burimet e kthjelltë nën ahishtë,
ku zogjtë krahëshkruar dhe zëëmbël cicërojnë pa pushuar ëmbëlsisht,
ndërsa meloditë si i dehur më fusin në gjumë mbretëror ngadalësisht.
6.
Që atëherë është rrokullisur e hedhur pas shpatullave mjaft kohë,
po hareja që m'u shfaq në rini mbeti te unë po ashtu siç qe dikur,
por prej përndjekjes së dashurisë sime të vërtetë e mjaft të lumtur,
mësova se më mirë ta kërkosh bukurinë brenda shpirtit të ngrohtë!
Tiranë, më10 shkurt 2005

136. D-iu ñi vini aistă mar' ambareaț

1.
A lăi soț a ñei di pisti ñ-spunaț d-iu ñi vini aistă mar'ambareaț,
ta s-mi scaldu ninga unoară pit șopori curaț ți s-curră sum fădz,
iu pul'i areaptimușaț și boațidulț țăru{22} cănțili a lor pisti dădz,
ți ca îmbitatu di melodili ți ti bag diunoară tu somn ca amerreaț.
2.
A lăi soț a ñei di viața, pisticiș ca buñăl'i fraț mi scăpaț di dor,
dusindalui ninga unoară s-alag la Padea Mușeaț a Noțnjilor,
iu cu giucari ș-căntari nicăpăsiti păn s-aprească dzua nau di nău,
s-li agărșim durerăli ți ni l'-aduți totna elu ca foc cărmăgău.
3.
Cum s-spuni di aușaț'l'i că Mușatea a Locului easi di cu dimneța,
s-speală anarga și cu harau la Lac Laiu, pisti pădurea di fădz,
și s-ascundi tu nicălcata păduri, când soarăli fudzi după prăndz,
aștăptăndalui s-easă când s-luñințiteași luna cu ma mușața.
4.
Pimtu dit aisti leghendi ti Mușatea a Locului p-iu nu îl'i u căftai,
ș-cățe ñ-alăsai inima lișoară, mușatușa a mea ca dzwnw s-ñ-află,
p-iu nu alăgai păn încl'ișu ficiuramea, ma mușata tu suflitu n-aflai,
l'i bitui ciciorl'i după năsă, ma mi convingă ma ghini ea s-mi caftă.
5.
A lăi soț a ñei di pisti ñ-spunaț d-iu ñ-vini aistă mar'ambareaț,
ta s-mi scaldu ninga unoară pit șopori curaț ți s-curră sum fădz,
iu pul'i areaptimușaț și boațidulț țăru cănțili a lor pisti dădz,
ți ca îmbitatu di melodili ți ti bag diunoară tu somn ca amereaț.
6.
Multu chirou í arucutită di atumțe pisti a meali pultări,
ma harau ți ñ-vini tru tinărami armasi și cum fu la mini,
ma dit îngănarea a vrutil'ei a mea di dealihea ș-ti m-ambari,
învățai că s-mutreești suflitlu di la mușateața í ma ghini,
Tirana, la 10 șkurtu 2005

137. Shqiptari

1.
Në oborrin e së bukurës Tushë në mëngjes herët të asaj dite pazari,
po shkarkonte mushkën shqiptari trim, i veshur hijshëm si dhëndër,
sa shkëmbeu shikimin me të u gjunjëzua prej bukurisë së tij të virgjër,
të shkretës vashë zemrën seç ia rrëmbeu dashuria e djalit syshkëndi.
2.
Seç na u zhyt në botën e ëndërrimeve vashëza Tushë përnjëherë,
ngado endej tok me shoqet e rinisë apo edhe krejt vetmazi me nge,
imazhi i hijshëm i shqiptarit trim pas e ndiqte pa u lodhur asnjëherë,
ndërsa i gëzonte shpirtin e përflakur prej së ëmblës bukuri djaloshare.
3.
Prej asaj dite, që bukuroshja Tushë vështroi atë bukuri të patreguar,
sa vinin në oborr mushkat e ngarkuara me thasë për t'u shkarkuar,
që të bluanin grurë në mullirin e tyre më të njohur në fshat cilësisht,
e, sa shihte se me të tjerët ish edhe shqiptari i saj trim fatmirësisht.
4.
me bucelëzën e bukurzbukuruar krahëhedhurazi dilte shpejtë gjojazi,
t'u ofrojë ujin e ftohtë të flerës pranë tyre duke u afruar ngadalazi,
gjersa arrinte te shqiptari trim, për të shkëmbyer dy-tri fjalë dashurisht,
ta shuaj përmallimin e fshehtë me shkëmbim shikimesh ëmbëlsisht.
5.
Kaluan ditë që kur bukuroshja Tushë prej pamjes së tij tërë hijeshi,
e rritur mes malesh të lartë loz nëpër ëndërrime të bukura vashërie,
po kush mund ta dijë se sa dhembje i shkaktoi kjo e fshehura dashuri,
sa herë shqiptari trim vonohej pa ardhur në oborrin e kësaj shtëpie.
6.
Atëherë bukuroshja Tushë shembej përtokë e zalisur e si ngordhur,
se s-do piqej me shqiptarin trim për të shkëmbyer dy-tri falë ëmbëlsisht,
po kur e shihte të shkarkonte thasë prej mushkës së ngarkuar përsëri,
nga gëzimi në dhomëzën e saj hidhte vallen e pa muzikë lumturisht.
7.
Prej asaj dite asnjëherë e shkreta Tushë s'e pa shqiptarin e saj trim,
edhe pse e shpirtpërflakur prej mallit vështronte nga oborri pa pushim,
ndaj natë e ditë tok me leshin në furkë tirrte dhebsurinë nëpër ëndrra,
por portreti e tij s'i humbi gjëkundi, e ndiqte pas si ikonat e shenjta.

137. Abineşlu

1.
Tru dzua di păzari, la oborulu a muşatil'ei Tuşă di cu dimneaţ,
dăscărcă mulara gionăli arăbănesu ca harambou învăscut muşeaţ
şi cât alăxi mutrita cu elu, s-znucl'i pri muşateţea nevidzut putei,
ali şcreti featiţă inimea l'i-s-arichi di dor a ficiorlui ocl'iscântei.
2.
Diunoară featiţă Tuşă s-hipsi tru duñeaua al yisuri a l'ei,
p-iuţido ţi indzea singuroasă ică diadun cu soţăli di tinăraţ,
fănărusira a arbăneslui gioni după îl'i u îngăna di pi niacurmaţ,
îl'i u hărisea suflitlu pirăfocoasu dit muştaţea gionască ca di zmei.
3.
Dit aţea dzuuă neagrişită ţi muşata Tuşă îl'i u mutra pri elu,
cât ori vinea mulărăli încărcati cu saţ ţi s-dăscărcă tru ubor,
s-maţăna gărru nău la ma cunuscutu moară a horil'ei a lor,
cât videa că stog cu bărbeaţ earea arbăneasulu gioni ca zmeu,
4.
cu troară inşa di castilea{23} cu buculia îmbraţ adreat muşaţ,
pri anarga s-apruchea ningă el'i s-ursească apă araţi di fleari,
păn s-agiungea la arbineşlu a l'ei gioni, s-alixea dau-trei zboari,
s-aplica ascumtulu dor ţi cu mutrităli a lui s-l'i-pitriţea ghineaţ.
5.
Tărcură dzăli di când muşata Tuşă di a lui mutrită cu ahânt nor,
giuacă pit yisuri muşaţ di featiţă cărscută namsa dit munţ,
ma cai poati s-l'i u şti cât dispirări ţi l'i-adusi aistu dor pri ascumţ,
când arbineşulu gioni s-amăna multu chirou nivănit tru ubor,
6.
Astumţea muşata Tuşa s-păscănea zălăpsită ca psohiă împadi
că nu vă s-adunea cu arbineşulu gioni s-alăxea dau-trei zboari,
ma când elu îl'i u videa di nău s-discarcă mulara îngărcat cu saţ,
di hărisimi la udaua a l'ei acăţa s-gioca încor di nipărmănaţ.
7.
Dit aţea dzuuă mărtea di Tuşă nu îl'i u vidzu arbineşulu gioni,
ş-căţe cu dor apreas ca foc mutrea di cât la uboru fără dănăseari,
ti aţea noapti-dzuă stog cu lăna pri furţ li turţea duruţăl'i a l'ei yisoñ,
ma portretlu lui nu îl'i u chiru iuvea, dinapoi îl'i u îngănea ca yicoñ.

138. Flamburi

1.
I përmalluar endem sot përmes vendesh të shtrenjta të fshatit tim,
tek i bukuri Shesh të Kryqit[1)] më shpunë këmbët e mija papriturazi
e po qëndroj mbi të ndanë shembishtës së kishës mëgjunjazi,
me vështrimin anembanë pemëve të larta gjer te kroi me gurgullim,
2.
menjëherë më ringjallen varganët zbritëtar prej malesh të lartë,
dhëndri i prirë prej fëllambarit me flamur[2)] tok me dasmorë,
duke kënduar e vallëzuar me gëzim rretherrotull pemës së lashtë,
e duke e përcjellë atë gjer tek ne si melodi të ëmbël ëngjëllorësh.
3.
Që aty dasmorët niseshin me fëllamburin majëkryq prej bredhi të ri,
fëllambarët të gëzuar niseshin të shpinin e ardhjes së tij me ngadalë,
e në fillim qëndronin në oborrin e bukur të shtëpisë së dhëndrit të ri,
duke i përndezur tërë të ftuarit me këngë e valle të bukura valë-valë.
4.
Fllamburtari, fllamburi tok me flamburtarët porsi atëherë përsëri,
edhe sot i nisin të uruarat arumunet dasma të ndezura rishtazi,
që ndjekin nuset e dhëndurët e ri me këngë e valle gazimplot,
gjersa të rrojë arëmënamea siç ka qënë, do jenë ato për nga mot!...

Tiranë, më 20.04.2006

1)Emër vendi. Sheshi i Kryqit, quhet sot. Në këtë vend ish ngritur kisha e Kryqit, Shën-Gjegji. Që aty nisej fllamburi me fllamburtarët e dasmave tok me dhëndrin e ri.
2)Një lloj majdegëze e zbukuruar që prijnë dhëndrin e ri zbret nga mali.

138.Flambura

1.
Pit aişţ locuri scunchi a hoarilei a mea alăg astădz umplut cu dor,
la Padea di la Cruţă1) mi duc ciciorl' a meali diniaştipteari,
şi ma stău pisti stoghiurl' alu aţilor muriştăli hiptu tu munduiri,
ño aruc mutritea part di parti păn la făntăna sum analtulu pom,
2.
şi diunoară ñ-s-yieascu hărăţiţl'i dipunăţ dipi analţl' munţ,
haramboulu părimnat di flamburtaru cu flambru ş-numţitor
cântandalui şi giucăndalui cu harau avărliga di un vlecl'iu pom,
şi aşiţ păn la noi astădz ñ-s-pitreaţi pit sufliţl'i hărăserea a lor.
3.
Di aco numţitorl'i cu flambrulu adreat di frăndz veardz di bradz,
flămbarl'i hărăsiţ s-închisea la hoară anarga pi muşeaţ aradz,
nănti chiundrea tu uborlu muşat a casilei o haramboulu nău,
aprindalui tuţ ancl'imaţl'i tu cănti ş-giocuri nisoniti di hărău.
4.
Flambutaru, flambura diadun cu flamburtarl'i năpoi ca atumţea,
ş-astădz diadunu l'i închisească arămăneaştli numţli apreasi năpoi,
cu cănţi, încoruri ţi îngănească înveastăli şi haramboulu dinăpoi,
cum fu, aşiţ vă s-hibă di aua ş-năinti păn s-băneadz Armâneamea!

Tirana, la 20.04.2006

1) Padea di la Cruţ, s-ăncl'eamă astădz. La aistu loc erea îngărvăsi biseara di la La Cruţă,Sămtu Ghierghi incă Ali Iorghi. Di la năsă s-ănchisea flambrulu, cu flambarl'i ali numti diadun cu haramboulu nău.

139. Shtëpia jonë

1.
Që kurse s'banoj më në shtëpinë tonë shumë kohë është rrokullisur,
këtu pranë lumit të Valamares, mbështetur pas shkëmbit të bardhë,
ndërsa brenda saj janë lindur shumë bij e bija të fortë e të bukur,
e që janë përkundur me dashurinë e nënave të tyre shpirtbardhë.
2.
E heshtur dhe e pa zë qëndron ende më këmbë përpara nesh sot,
ne t'i njohim njëlloj si ti të gjitha skutat e ngjarjet e përjetuara tok,
por edhe të kuptojmë mirë se ç' kërkon prej të adhuruarve bij të tu,
e çdo brez kur na ke thirrur të jemi përgjigjur dashurisht gjithashtu.
3.
Ndaj cili më mirë se ne do të bisedonte për ëndrrat e tua të bukura,
për trimat e veshëzat e bukura si zana, që ecin nëpër udhë të mbara,
e ndaj sot je bosh nga të thirrurat e fëmijëve tek ngasin kuajt në lëmë,
po përpiqemi sesi të mos të lëmë më si jetime ndanë rrugës pa mëmë.
4.
Erdhi dita të vijmë tek ti për të të zbukuruar nga ç'ishe më bukur,
që t'u rrëfejmë sesi na përkundën mëmat tona në djep me përmallim,
se është thënë prej Perëndisë në të të rriten fidanë rinj pambarim,
si dhe për barinjtë arumunë tek nisen herët pas tufave për t'i kullotur.

139. Casa a noastă

1.
Multu chirou í arucutit di când nu s-bănedz la casa a noastă,
aua pi ningă Valemare andupurit priună mari alboasi cheatră,
încât nuntru la ea sunt amintaț caiști cât hil'i și hil'e mușeaț
și la sărmănițăli a l'ei cu dorulu di a lor dădi sunt lignaț.
2.
Dinânti di noi astădz ma ni stăi împroastă tățitoasă, fără boață,
noi ți li cunușteam multu ghini, că ți undziri la ea sunt giucaț,
ma ș-ti-duchim că ți vrei s-cafț pri a noi hil'i adoreațili a tăi,
și ti him răspusără băr di băr di unoară cât ni ai căftat părmini.
3.
Ti ațea cai cama ghini di noi poati s-zburească ti a tali yisari,
ti gioñăl' și featițăli mușatuși ca dzăni, ți imn pit căl'uri ambari,
tri ațea astădz ți ai armasă goală fără zghilirili a giocuri di ficiurițț,
ma ni cilistisim s-nu t-alăsăm ca yitimă{24} pi ningă cali, him convinsiț,
4.
Vini dzua s-vinim la tini s-ti adărăm di ți fuș ma mușeaț,
ta s-l'i u spunem cu dor că cum him lăgăneaț la tuniț di dădăñ,
că esti dzăsă di la Dumnidzeu tru ea s-creascu năi fildăñ,
ș-ti picurarl'i arămăñ ți îngănu turmăli di oi di cu dămneaț.

140. Pranë shtëpisë sime

1.
Pranë shtëpisë sime të thjeshtë, ndodhet një gur i madh ngjyrgri,
ku ne loznim ditë për ditë, së toku me vërsnikët e fëmijërisë sime,
dhe gjer më të ngrysur përmbi të duke u ngjitur e shqitur rishtazi,
nga që më griseshin shallvaret e shtrenjta nënë Klanta më fliste.
2.
Prej lojës sonë së marrosur fëminore ato ishin bërë copa-copa,
nga rrëshqitja e pamenduar se ç'mund të na ndodhte papritmazi,
dhe se çfarë pune do t'i hapnin asaj, nëse ato do t'i thurte rishtazi,
e shkreta që tërë natën e natës do të lozë gishtat pa pushim me shtiza.
3.
Të nesërmen besën, për të mos e përsëritur e harronim me papjekuri,
fshehurazi prej saj e nisnin rrëshqitjen përmbi gurin e hirtë përsëri,
ndërsa buzëmbrëmjeve i frikësuar futesha në shtëpi vjedhurazi ngadalë
dhe mendoja sesi t'i shpëtoja zemërimit të saj, duke i shkarë si ngjalë.
4.
Kështu u rrokullisën ditët e fëmijërisë sime, mbushur plot me lodra,
së bashku me prindërit e mi të dashur, në mes këtyre malesh të lartë,
pa u menduar se ç'do të na sillte e ardhmja, që vinte gjithnjë e më qatrë,
e mbuluar me mallin prindëror, ca nga ca u rritëm pa bukë në sofra.
5.
Pranë shtëpisë sime të thjeshtë ndodhet një gur i madh ngjyrgri,
ku ne loznim ditë për ditë së bashku me vërsnikët e fëmijërisë sime,
dhe gjer më të ngrysur përmbi të duke u ngjitur e shqitur rishtazi,
nga që më griseshin shallvaret e shtrenjta nënë Klanta më fliste.

140. Ningă a casil'ei a mea

1.
Ningă a casil'ei a mea easti un cheatru murgă multu mari,
iu giucam dzuuă di dzuuă, diadunu cu vrăsl'i tu ñicuriţa a mea,
alichindalui şi aruchişceari pisti năsu păn pri întunicari,
scumpea dadă Clantă, ni bătea că pantalonili a ñia ñ-s-arupea.
2.
Dit gălăritulu gioculu a nostu eli eara fapti bucăţ-bucăţ,
din aruchişearea fără di minti tuti soi poati s-ni undzească,
şi că ţi lucru li disfăţeam a l'ei când năpoi s-îl'i împăltească,
măratea ţi tută noptea vă s-gioc dzesţl'i di nidănăsit cu crădz.
3.
Ma dzua alantă agrişeam că ţi pisti noi l'-aveam data di nicoptil'ei,
ahiurheam aruchişarea pisti murgu cheatru pri afriştea di năsă,
încăt, când ningă seară fricuşitu ş-pri ascumtea intream în casă,
traptindalui ca păntitu mundueam că cum s-îl'i scăpam a învirarl'ei.
4.
Aşi s-arucutiră dzălăli a ñicuramil'ei a mea, umplut cu giocuri,
diadun cu părinţl'i a ñei vruţ, namsa dit aişţ analţ munţ,
niminduită că ţi vă s-ni aduţea yinitorlu ţi ma yini pri ascumţ,
amvălit di dorulu părinteasc, nihima cât nihiam cărscum cu suferiri.
5.
Ningă a casil'ei a mea easti un cheatru murgă multu mari,
iu giucam dzuuă di dzuuă, diadunu cu vrăsl'i tu ñicuriţa a mea,
alichindalui şi aruchişceari pisti năsu păn pri întunicari,
scumpea dadă Clantă, ni bătea că pantalonili a ñia ñ-s-arupea.

141. Rrodhja

1.
O moj rrodhe, që më rritesh ndanë mezhdash a nën ferrishta,
këtu, për cilëndo gjë të gjallë a njeri të veshur me veshje të leshta,
u ngjitesh pas dhe asnjëherë me dashjen tënde s'u shqitesh vetë,
po gratë punëtore arumune, me duart e veta u tëharrin vërtetë.
2.
Cili arumun a arumune s'të njeh ty moj gjembaçja rrodhe,
shumë mallkime hidhen mbi ty, sa herë u ngjitesh nga pas,
nëpër bashkën e deleve, duke kullotur mezhdave pa asnjë mas'.
ndaj thërresim ndonjëherë me fjalën e rrallë tallëse "rrodhe!"
3.
Ngado rritesh ti moj rrodhëz me plot gjemba e tu majëmprehtë
atje u pëlqen dhenve tona të kullosin me shije nën pisha përherë,
po barinjtë e mençëm arumunë i përzënë prej andej menjëherë,
se duan që gratë e tyre të mos u lodhen veç prej jush në këtë jetë.
4.
O moj rrodhe, që më rritesh ndanë mezhdash a nën ferrishta,
këtu për cilëndo gjë të gjallë a njeri të veshur me veshje të leshta,
u ngjitesh pas dhe asnjëherë me dashjen tënde s'u shqitesh vetë,
po gratë punëtore arumune me duart e veta u tëharrin vërtetë.

142. Boshti

1.
Rrotullohet boshti nëpër duarpuntoret e arumuneve pa pushim,
me të shpejtë tjerrin leshin e bardhë të dhenve duke ëndërruar,
përzihen duart me fillin e leshtë prej boshtit gjithnjë i rrotulluar,
që varet gjer në tokë e përsëri ngrihet në rrotullim pambarim.
2.
Përmbi këto gra arumune të ndershme e punëtore duararta,
edhe pse i rreh në ballë ditë e natë pa u shterur era me tërbim,
edhe pse i stërreh era e jetës rëndë me tërëcëllimë pa mbarim,
atyre s'ju humbet bukuria asnjëherë, po veç jesin rrëzëllimarta.

141. Săcaia

1.
Ale săcai ți ti-încreaşti mardzinea di adzări pit mejdi{25}
pi țido pravdi a om la noi, învăscut cu-învăşteari di lănă,
ti alicheaşti şi putei singur nu ti împarţ di pi eali,
ma lucurtoari mul'eari armâni, ti discurmă cu măñă.
2.
Cai di armâñ ş-di armâncă nu ti cunoaşti pri tini,
căt blăstemñ să silgheascu ti tini când l'i u s-alicheaşti,
la păşteari pit mejdi a pit arudzăl'i la noi după lăna di oi,
ti ațea ți strigăm cu puzeari cu zborulu "săcai" di dinăpoi.
3.
Iutsido creaşti tini săcai, ți ni înțeachi cu a tali schiñ,
aco arisească s-pască cu nostimă oili a noasti sum chiñ,
ma picural'i armâñ mintimeñ, vi azguñeascu cu troară,
că vor ți mul'earăli s-nu s-îl'i u s-acurmu di voi văroară.
4.
Ale săcai ți ti încreaşti mardzinea di adzări pit mejdi
pi țido pravdi a om la noi, învăscut cu învăşteari di lănă,
ti alicheaşti şi putei singur nu ti împarţ di pi eali,
ma lucurtoari mul'eari armâni, ti discurmă cu măñă.

142. Fustu

1.
Giocă fustu pit măñăl'i dit armânci fără di căpăsiri,
si să tiriască lăna di oili albi hipti tu yisuri muşaţ,
să meastăcă măñăl'i cu hirulu dipi fustu ţirculeaţ,
ți cadi păn pri padi şi năpoia s-scoală fără bintisiri.
2.
Pisti aisti mul'eari armânci multu lucrătoari ş-tăñisiti,
şă căţe li bati noapti-dzuuă vintulu ca turbatu pisti frămti,
şă căţe li străbati vintulu a viațiľei greuă fără di căpăsiri,
a lor nu l'iu-cheară muşteţea, ma lucineascu ş-cu minti.

3.
Rrotullohet boshti nëpër duarpunëtoret e arumuneve pa pushim,
me të shpejtë tjerrin leshin e bardhë të dhenve duke ëndërruar,
të thurin veshje të bukura e të forta për trimat e tyre të dëgjuar,
e dimrit të shtegtonin tufat e dhenve në bregdet për dimërim.
4.
Pastaj, kur tendoset ngado përmbi tokë errësira e thellë e natës,
mos harroni t'i mbuloni të bukurat ato, me puthje plot përmallim,
me fjalë të ëmblatha, të bukurza e të shijshme, si frutat në mbarim,
gjersa në krahët tuaj të fortë t'i rrëmbejë gjumi i ëmbël prej vapës.

143. Sovajka

1.
Kush më mirë se ju duararta gra arumune punon në avlëmend,
sa i ngrehni më këmbë nisni të endni të bukurat qilima me durim,
të kërrusura mbi të ndiqni me duar sovajkën që shkon-vjen pa pushim,
kështu mbijetojnë ato, duke ëndërruar për takimin me trimin levend.
2.
Në tërë Shqipërinë s'gjendet ndonjë shtëpi pa qilima të shtruara,
të endura nga duart e tyre punëtore, me dashuri e zbukurimrrallë,
duke derdhur mbi to, me fantazinë e saj, lloj-lloj bukurish plot mall,
motive të përzgjedhura luledeleve, të çelura në vise të pashkelura.
3.
Lodhja prej punës së rëndë në ndjekje të sovajkës mbi avlëmend,
asnjë arumune s'e harron vuajtjen e punës krijuese gëzimdehëse,
ndërsa i përcillnit ikje-ardhjet e saj, gjer në të gdhirë të ditës së re,
edhe pse djersa, si milingonat, ju shpëlan pa prerazi në çdo vend.
4.
Kjo fama juaj e madhe, si duararta punëtore nga s'është përhapur,
nëpër gadishullin e Ballkanit, ku banoni të shpërndarë me detyrim,
me popuj të tjerë, krejt të ndryshëm me arumunët, në bashkëbanim,
jashtë mentalitetit të nacionalizmave të vjetër, në paqe e të lumtur,

3.
Giocă fustu pit măñăl'i dit armânți fără di căpăsiri,
si să tiriască lăna di oili albi, hipti tu yisoñori mușați,
s-adaru învățeari buni tri gioñăl'i a lor avdzăț,
și di iarna s-li ducă tu arniu turmăli di oi fără di arcoari.
4.
Dapoia, când s-s-tindi piuțido pisti biloc chisa ali noapti,
nu agărșiț s-l'i îmvăliț mușeatăli di eali, cu bașii di dor,
cu zboari dulțoasi, mușeatoasi, nostmioasi, ca pomñ coapti,
păn eali la brațl'i a voșț s-îl'i arăchească dulțăli somn cu nor,

143. Sua

1.
Cai ma ghini di voi mul'eari armâni lucreaț tu războiu,
di când vi sculeaț împroasti pri cicior s-adraț sazmăli mușeaț,
pri eali asăraț cu măñ sua ți yini ș-fudzi nidănăsaț,
și străbăneadz eali yisăndalui andamusea cu a lor haramboiu.
2.
Tu întreagă Arbinișia nu s-află vărnă casă niaștrăt cu zăzmi,
dit măñăli lucurutoari a lor, sunt adărati tuti eli mușeaț-mușeaț,
vărsăndalui fantazia a lor, cu dor pisti năsi cu soi di soi di mușteaț,
motivi aleapti cu vreari pit lilicili agri, ți s-disfac pit bilocuri nicălcati.
3.
Acurmarea cu lucru greu anda îngăneești sua tu războiu,
nițiună armâncă nu îl'i u agărișești suferință a fățeariei di hărăiu,
ma păn pri aprita a naul'ei dzuuă pitrițeț vinir-fudzirea a l'ei,
și cățe sudoarea, ca furidz lucărtoari, nu căpăseascu putei.
4.
Piu nu ieasti disfaptă fama a avoastă di măñ lucrutoari,
pit piuțido tru pensula Balcan, iu arăspăndiț astădz bănaț voi,
ți băneadz diadun cu alanț mileț, ți cu arămăñ sunt altăsoi,
cu tăñi, cu păci, nafoară di mentalitetulu a nacionizmăl'iei agri.

5.
Kështu, duke punuar e derdhur djersën, si ujëvarë faqeve pa pushim,
keni rrojtur të përzierë me popujt e tjerë të gadishullit tonë të vjetër,
prej shumë shekujsh, së toku me shqiptarë, bullgarë, serbë e grekë,
pa egoizmin nacionalist, jeni treguar si miq të sinqertë në vëllazërim.
6.
Nga ju burrat trima arumunë dhe ju gra punëtore duararta si zana,
vilet mentaliteti i mbushur me dashurinë e madhe të së bukurës jetë,
